



**Komuna e  
DEÇANIT**

**2012/2017**

*...për qytetin tim!*

# Plani Lokal i


# Veprimet në Mjedis





# Plani Lokal i Veprimit në Mjedis

2012/2017



Komuna e Deçanit

Projekti është financuar nga:



Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar.

Zbatimi i projektit është mbështetur edhe nga:



MMPH dhe MAPL.

Ky projekt është zbatuar nga:



**REGIONAL ENVIRONMENTAL CENTER**

Qendra Rajonale e Mjedisit, REC – Zyra në Kosovë.

---

Botim i Qendra Rajonale e Mjedisit, REC – Zyra në Kosovë.  
<http://kosovo.rec.org/>; <http://www.rec.org/>

PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS 2012/2017

Copyright © 2012 REC

Të drejtat e botimit të këtij publikimi i mban:

Qendra Rajonale e Mjedisit, REC – Zyra në Kosovë

Design & Layout: Arben Grajqevci (Rrjeti)

Shtypi: RRJETI, Prishtinë

# Përmbajtja

Ç'është REC? .....	8
Fjala e Kryetarit të Komunës.....	9
Fjalorthi i shkurtesave.....	10
Akterët dhe përgjegjësitë e PLVM-së.....	11

## Pjesa 1

I.HYRJE .....	15
Detyrimet ligjore për hartimin e PLVM-së .....	15
Plani lokal për Veprim në Mjedis ka për qellim të: .....	15
Metodologjia e përgatitjes së PLVM-së .....	16
Dokumenti është i hartuar mbi tri baza kryesore:.....	17

## Pjesa 2

ANALIZA E GJENDJES MJEDISORE .....	19
1. TË DHËNAT E PËRGJITHSHME PËR DEÇANIN .....	20
1.1. Pozita gjeografike .....	21
1.2. Relievi .....	22
2. 3. Klima.....	23
1.4. Popullsia .....	23
2. PASURITË NATYRORE.....	24
2.1. Minerale.....	24
2.2. Pyjet .....	24
2.3. Toka bujqësore .....	25
2.4 Tokat erozive.....	26
3. BURIMET UJORE .....	27
3.1 Lumëbardhi i Deçanit.....	27
3.2. Lumëbardhi i Lloqanit.....	28
3.3. Uji mineral.....	28
4. EKONOMIA .....	29
4.1. Punësimi .....	29
4.2. Barazia gjinore .....	29
4.3. Industria .....	30
4.4. Bujqësia.....	30
4.5. Prodhimtaria perimore .....	31

4.6.	Zhvillimi i pemëtarisë.....	31
4.7.	Blegtoria .....	32
4.9.	Energjia.....	33
4.10.	Turizmi dhe hoteleria .....	33
4.11.	Bizneset private .....	34
5.	INFRASTRUKTURA DHE SHËRBIMET PUBLIKE .....	35
5.1.	Ujësjetlësi dhe kanalizimi .....	35
5.2.	Menaxhimi i mbeturinave .....	35
6.4.	Infrastruktura rrugore dhe transporti publik .....	36
6.4.	Ndriçimi Publik .....	36
6.5.	Shërbimet e telekomunikacionit dhe mediat .....	36
7.	SHËRBIMET SOCIALE.....	37
7.1.	Arsimimi .....	37
7.2.	Shëndetësia .....	37
7.3.	Trashëgimia natyrore .....	38
7.4.	Trashëgimia kulturore .....	43
8.	GJENDJA E MJEDISIT .....	44
8.1.	Ajri.....	44
8.2.	Zhurma.....	45
8.3.	MENAXHIMI I UJIT .....	45
8.3.1.	Furnizimi më ujë të pijshëm.....	45
8.5.	Rrjeti i ujësjetlësit .....	45
8.6.	Rrjeti i kanalizimit atmosferik - gjendja ekzistuese .....	46
8.7.	Trajtimi i ujërave të ndotura - gjendja ekzistuese .....	46
8.8.	Ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore .....	46
9.	MENAXHIMI I MBETURINAVE .....	47
9.1	Mbeturinat urbane .....	47
9.2	Mbeturinat speciale .....	48
9.3	Gjelbërimi.....	48
10.	Planifikimi hapësinor komunal .....	49

## Pjesa 3

III. Identifikimi i Problemeve .....	51
Ujërat .....	51
Toka (Dheu) .....	52
Ajri .....	53
Biodiversiteti .....	53
Mjedisi social dhe ekonomik .....	54
Turizmi .....	54

## Pjesa 4

IV. Planifikimi i Veprimeve .....	55
1. Uji .....	56
2. Toka .....	57
3. Ajri .....	58
4. Biodiversiteti .....	59
5. Mjedi social dhe ekonomik .....	60
6. Turizmi .....	61
Plani i veprimit për implementim .....	62
Trajtimi ujërave dhe mbrojtja e lumenjve .....	62
Ndërtimi i kanalizimeve për ujërat e zeza dhe kolektorëve .....	63
Menaxhimi i mbeturinave .....	63
Mbrojtja nga erozioni dhe vërshimet .....	64
Ajri 64	
Zonat e gjelbra .....	65
Zhvillimi i turizmit .....	66
Trashëgimia kulturore dhe natyrore .....	67

## Pjesa 5

V. Lista e Prioriteteve Mjedisore .....	69
1. REZULTATET E ANKETËS PËR PRIORITETET .....	69
DEÇANI .....	69
Literatura/Referencat .....	97



## Ç'është REC?

Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) është organizatë ndërkombëtare neutrale, joavokuese dhe jofitimprurëse, e cila mbështet zgjidhjen e problemeve mjedisore në Evropën Qendrore dhe Lindore (EQL). Kjo qendër e përmbush misionin duke promovuar bashkëpunim ndërmjet Organizatave Jo Qeveritare (OJQ), qeverive, bizneseve si dhe personave tjerë kyç mjedisor si dhe duke përkrahur këmbimin e lirë të informatave dhe pjesëmarrjen publike në vendimmarrjen për mjedis. REC është themeluar në vitin 1990 nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Komisioni Evropian dhe Hungaria.

Aktualisht, REC bazohet ligjërisht në Kartën e vet, nënshkruar nga qeveritë e 29 vendeve dhe Komisioni Evropian dhe në një marrëveshje ndërkombëtare me qeverinë e Hungarisë. Zyra qendrore e REC-ut është në Szentendre, Hungari si dhe zyrat fushore dhe zyrat e shteteve në 17 vendet përfituese.





## Fjala e Kryetarit të Komunës

*Të nderuar qytetarë të Komunës së Deçanit*

**P**lanit Lokal i Veprimit Mjedisor për Komunën e Deçanit është dokument i politikës mjedisore-lokale, i cili paraqet gjendjen e mjedisit dhe veprimeve përkatëse, që duhet ndërmarrë për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit.

Qëllimi kryesor i këtij plani është krijimi një strategjie për eliminimin e problemeve të ndotjes së mjedisit dhe tejkalimin e tyre. Ky dokument do të shfrytëzohet edhe si mundësi për promovimin dhe vendosjen e themeleve organizative dhe ekonomike, të bazuara për zhvillim të qëndrueshëm të Komunës.

Hartimi i këtij plani është mbështetur në pjesëmarrjen aktive të institucioneve përkatëse (lokale dhe qendrore), të komunitetit lokal dhe organizatave joqeveritare.

Realizimi i aktiviteteve të propozuara është proces afatgjatë, i cili duhet të realizohet nëpërmjet hapave të vegjël në mënyrë racionale. Ky dokument do të t'ju shërbejë të gjithë akterëve, vendas dhe të huaj, që të fokusohen në investime në fushën e mjedisit dhe shfrytëzimin sa më racional të resurseve natyrore.

Për realizimin e këtij plani, dua të falënderoj Agjencinë Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida), Qendrën Rajonale të Mjedisit (REC-un), gjithashtu për mbështetje dhe përkrahje edhe komunitetin lokal, si dhe organizatat joqeveritare.

*Kryetari i Komunës  
Rasim Selmanaj*

## Fjalorthi i shkurtesave

LEAP	- Local Environmental Action Plan
REC	- Qendra Regjionale për Mbrojtjen e Mjedisit për Evropën Qendrore dhe Lindore
Sida	- Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar
OJQ	- Organizatat Joqeveritare
SHP	- Shërbimet Publike
NP	- Ndërmarrje Publike
KEK	- Korporata Energjetike e Kosovës
SHGJ	- Shoqata e Gjuetarëve
MMPH	- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
TK	- Trupa Koordinuese
GP	- Grupet Punese
SH. F.	- Shkolla Fillore
NVM	- Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
BL	- Bashkësitë Lokale
USAID	- Agjencioni Ndërkombëtar për Zhvillim e SHBA-ve
CDF	- The Community Development Found - Fondi për Zhvillimi Komunitar
NCA	- Norwegian Church Aid (Ndihma e Kishës Norvegjeze)
UNDP	- Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
MID	- Menaxhimi i Integruar për Dëmtuesit
PZHK	- Plani Zhvillimor Komunal
PZHU	- Plani Zhvillimor Urban
PRRU	- Plani Rregullues Urbanistik

## Akterët dhe përgjegjësitë e PLVM-së

Ky Projekt është implementuar nga:

**Qendra Rajonale e Mjedisit, REC** (Regional Environmental Center) - Zyra në Kosovë.

Koordinatorë e REC për PLVM:

Adem LUSHAJ

### **Komuna e Deçanit**

Koordinator i Komunës për PLVM:

Ajne IBERHYSAJ

### **Anëtarët e Trupit Koordinues:**

- |                    |                                                               |
|--------------------|---------------------------------------------------------------|
| 1. Rasim Selmanaj  | - Kryetar i Komunës                                           |
| 2. Ramë Meli       | - Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit |
| 3. Ajne Iberhysaj  | - Koordinatorë e Komunës për PLVM                             |
| 4. Bashkim Ramosaj | - Drejtor i Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme       |
| 5. Jashar Dobraj   | - Kryesues i Kuvendit (Asamblesë)                             |
| 6. Agron Demukaj   | - Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa                 |

**Anëtarët e Grupit Punues:**


- |                       |                                                                |
|-----------------------|----------------------------------------------------------------|
| 1. Ajne Iberhysaj     | - Koordinatore e Komunës për PLVM                              |
| 2. Ramë Meli          | - Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit |
| 3. Shkelzen Shehu     | - Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit |
| 4. Hyse Dinaj         | - Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit |
| 5. Musa Mushkolaj     | - Menaxher i Njesisë Regjionale “HidroDrinit” - Deçan          |
| 6. Jashar Dobraj      | - Kryetar i Kuvendit                                           |
| 7. Bashkim Ramosaj    | - Drejtoria e Administratës së Përgjithshme                    |
| 8. Blerim Bajraktaraj | - Biznes privat                                                |
| 9. Zoje Sejfiya       | - Zyrtare për Barazi Gjinore                                   |
| 10. Hane Lekaj        | - Drejtoria e Inspektionit                                     |
| 11. Jashar Hulaj      | - Drejtoria e Inspektionit                                     |
| 12. Mujë Kadrijaj     | - Drejtoria e Inspektionit                                     |
| 13. Shkelzen Goçi     | - Drejtoria e Inspektionit                                     |
| 14. Besmira Iberhysaj | - OJQ - “Jeta”                                                 |
| 15. Admir Hasanaj     | - Drejtoria për Shërbime Publike                               |
| 16. Sadik Ismajlaj    | - Shërbimet Publike                                            |
| 17. Beqir Kadrijaj    | - OJQ - “SHIP”                                                 |
| 18. Ajshe Bozhdaraj   | - Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër                          |
| 19. Haxhi Thaqi       | - OSBE                                                         |

Baza ligjore për hartimin e PLVM-së



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVA  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT  
MUNICIPALITY OF DEÇAN  
OPSTINA DEÇANI



Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-025 Për Mbrojtje të Mjedisit, si dhe Planit për Hartimin e Veprimit në Mjedis Lokal, dhe Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-40 të nenit 13, Statutit të Komunës neni 55 pika 20, Njoftimit të Asamblesë Komunale të dt. 30/09/3011 më nr. të protokollit 02/4901, Kryetari i Komunës me dt.21.09.2011, bie këtë:

**VENDIM**

**Për hartimin e Planit Lokal për Veprim në Mjedis**

**Neni 1**

Më qëllim të mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm komunal në Komunën e Deçanit bëhet hartimi i Planit Lokal për Veprim në Mjedis.

**Neni 2**

Plani Lokal për Veprim në Mjedis duhet të përmbajë të gjitha elementet themelore, të cilat janë përcaktuar në nenin 24 të Ligjit për Mbrojtjen të Mjedisit më Nr. 03-L 025, dhe elementeve strategjike të Planit të Kosovës për Veprim Mjedisor.

**Neni 3**

Ngarkohet Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit- Sektori i Mjedisit për hartimin e Planit Lokal për Veprim në Mjedis, në bashkëpunim me Drejtoratet e Komunës së Deçanit.

**Neni 4**

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit në bashkëpunim me Drejtoratet e Komunës së Deçanit, Kompanitë Publike, OJQ-të, Komuniteti, duhet të sigurojë të dhënat për përgatitjen e Planit Lokal për Veprimin Mjedisor.

**Neni 5**

Plani Lokal për Veprimin Mjedisor në përputhje me këto udhëzime dhe nën kushtet dhe parametrat e ligjit të cekur duhet të zbatohen sipas dispozitave ligjore, rregulloreve dhe normave përmes Buxhetit të Komunës së Deçanit.

**Neni 6**

Projekti prioritar, që do të dalë nga dokumenti i Planit Lokal për Veprimin Mjedisor, do të bashkë financohet nga Komuna e Deçanit, më participim financiar të mjeteve prej 20 mijë (njëzet mijë ) euro, dhe nga SIDA (Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar), participim financiar prej 40 mijë (katërdhjetë mijë ) euro.

**Neni 7**

Ky vendim hyn në fuqi me ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës Rasim Selmanaj.

Deçan, dt. 21.09.2011

DALËSE-FLIZINA-OUTGOING		Nr. Prot: 9901	
REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA		Dt. Fyrt:	
KOMUNA E DEÇANIT - OPSTINA DEÇANE - DEÇANI MUNICIPALITY		Prot. No:	
Njësia Org.:	<i>Zyra kryesore</i>		
Drejtuesi:			
Org. Unit.:			
Nr. i fletëve:	02	Datë:	21-09-2011
Drejtuesi:		Datë:	
No. Përges.:			
DEÇAN DEÇANE			

Kryetari i Komunës  
Rasim Selmanaj

Faqe 1 nga 2

**Legjislacioni i Republikës së Kosovës në fushën e mbrojtjes të mjedisit harmonizuar me standardet evropiane që është përdorur si referencë për përgatitjen e PLVM-së.**

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit (2009/03-L-025)
- Ligji për Mbeturinat (2005/02-L30)
- Ligji për Mbrojtjen e ajrit (2004/30)
- Ligji për Mbrojtjen e bimëve (2006/02-L95)
- Ligji për Mbrojtjen e natyrës (2005/02-L18)
- Ligji për Mbrojtjen e varieteteve të bimëve (2007/02-L98)
- Ligji për Mbrojtjen nga zhurma (2007/02-L102)
- Ligji për Mbrojtjen nga zjarri (2006/02-L41)
- Ligji për Bujqësi dhe zhvillim rural (2009/03-L-98)
- Ligji për Bujqësi organike (2007/02-L122)
- Ligji për Gjuetinë (2005/02-L53)
- Ligji për Plehrat Artificiale (2003/10)
- Ligji për Planifikim Hapësinorë (2003/14)
- Ligji për Pyjet ndryshim (2004/29)
- Ligji për Ujërat (2004/24)
- Ligji për Ujitjen e tokave bujqësore (2005/02-L9)
- Ligji për Vlerësimin e ndikimit në mjedis (2009/03-L-024)
- Ligji për Vetëqeverisje Lokale (2008/03-L040)
- Ligji për Zonat e veçanta të mbrojtura (2008/03-L039)
- Ligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (2009/03-L-015)
- Udhëzimi administrativ Nr 02/07 për mbeturina nga Bateritë dhe Akumulatorët
- Udhëzimi administrativ Nr 03/07 për administrimin e vajrave të përdorura mbeturinë
- Udhëzimi administrativ për automjete e hedhura dhe mbeturinat e tyre, 20.12. 2006
- Udhëzimi administrativ Nr. 12/2008 për asgjësimin e mbeturinave medicinale
- Udhëzimi administrativ Nr. 05/2008 për administrimin me mbeturinat medicinale
- Udhëzimi administrativ Nr. 05/2009 për administrimin e mbeturinave publike
- Udhëzimi administrativ Nr. 04/2009 për ndëshkime dhe gjoba mandatore
- Planin Kombëtarë për Veprim në Mjedis i Kosovës, 2006-2010

# Pjesa 1

## I. HYRJE

Planet Lokale të Veprimit në Mjedis (PLVM) janë dokumente të politikës mjedisore vendore, të cilat paraqesin prioritete mjedisore dhe listën e veprimeve për zgjidhjen e tyre. Përgatitja e këtyre planeve zhvillon më tej aftësitë e pushtetit vendor dhe subjekteve të tjera të interesuara për mjedisin dhe komunitetin.

Gjithashtu, PLVM nxit bashkëpunimin midis shoqërisë civile, publikut, pushtetit vendor dhe atij qendror, biznesit dhe subjekteve të tjera mjedisore, duke përkrahur shkëmbimin e lirë të informacionit dhe pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes.

### Detyrimet ligjore për hartimin e PLVM-së

Përgatitja e PLVM-së është e detyrueshme për vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore që kanë filluar procesin e asocim-stabilizimit dhe që synojnë të integrohen në BE. Për vendin tonë, hartimi i këtyre planeve nga qeverisjet vendore është detyrë ligjore, e përcaktuar në Nenin 24 të Ligji për mbrojtjen e mjedisit Nr.03/L-25

### Plani lokal për Veprim në Mjedis ka për qëllim të:

- Zgjidh problemet mjedisore nëpërmjet identifikimit të prioriteteve dhe përcaktimit të veprimeve për zgjidhjen e tyre, duke përfshirë të gjithë aktorët e mundshëm për përcaktimin e këtyre veprimeve dhe krijimin e strategjive për zbatimin e tyre në mënyrë efektive, të ndërthurura sipas një Plan Veprimi.
- Zhvillojnë shoqërinë civile nëpërmjet forcimit të koordinimit dhe komunikimit ndërmjet sektorëve të ndryshëm në komunitet, duke sjellë së bashku përfaqësues të komuniteteve të ndryshme që përfaqësojnë interesa të ndryshme në këto komunitete, përfshirë autoritetet vendore, përfaqësues të OJQ-ve, biznesin, shkencëtarë, duke shpjeguar teknikat specifike që organizatorët lokalë mund të përdorin për të përcaktuar aktorët kryesorë të procesit, të rrisin pjesëmarrjen dhe kontributin e publikut në proces, për rekrutimin dhe punën me vullnetarët dhe nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet grupeve të interesuara dhe organizatave.
- Rrisin aftësitë e qeverisjes vendore dhe komunitetit për paraqitjen e elementëve thelbësore

<sup>1</sup> "Hani i Elezit me rrethinë" -Emrush Dernjani, Hani i Elezit

të planit të veprimit të komunitetit, duke vlerësuar problemet dhe mundësitë komunitare, duke organizuar komitete qytetare, duke përfshirë publikun, përcaktimin e prioriteteve, hartimin e strategjive dhe zhvillimin e një Plan Veprimi.

- Rrisin shkëmbimin e informacionit në nivel lokal nëpërmjet sjelljes së shembujve dhe modeleve nga plane të mëparshëm të komuniteteve nga të cilat pjesëmarrësit mund të nxjerrin ide dhe teknika të zbatueshme në rastet konkrete të tyre, të mbledhin me kujdes informacion mbi gjendjen e tanishme të mjedisit.
- Japin zgjidhje konkrete për problemet e komunitetit me anë të shkëmbimit të përvojave lidhur me përdorimin e aftësive në analiza, planifikime, debate dhe vlerësime që janë thelbësore për një veprim të komunitetit efektiv. Duke u dhënë pjesëmarrësve mundësinë për të vënë në praktikë punën në grupe, duke u marrë me zgjidhjen e problemeve praktike nëpërmjet ndërveprimit të grupeve të vogla të punës.

## Metodologjia e përgatitjes së PLVM-së

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis për Komunën e Deçanit u hartua përgjatë një periudhe njëvjeçare dhe në hartimin e tij, janë përfshirë akterë të pushtetit vendorë dhe komuniteti i gjerë. Për këtë u ngrit një grup pune me specialistë të fushave të ndryshme (ambientalizëm, arkitekturë, turizëm, shëndetësi, arsim, sport, trashëgimi kulturore, etj.), të cilët punuan në bashkëpunim me ekspertë tjerë vendor dhe ndërkombëtarë për hartimin e PLVM.

Së pari, është bërë trajnimi i grupit punues të cilët u ftuan në projekt në aspektet e hartimit të PLVM-së dhe gjetjes së mjeteve shtesë për realizimin e aktiviteteve për përmirësimin e cilësisë mjedisore.

Në kuadër të projekti për hartimin e Planit Lokal për Veprim në Mjedis (PLVM), është bërë një anketim i qytetarëve të Komunës së Deçanit. Ka qenë një numër i konsiderueshëm i pyetësorëve, të cilët kanë ndihmuar dhe orientuar grupin punues në mënyrë më të drejtë në zgjedhjen e fushave prioritare. Një falënderim për këtë i takon qytetarëve të Komunës së Deçanit dhe shoqërisë civile, e cila në procesin e anketimit të respondentëve ka ndihmuar që procesi i anketimit të jetë i suksesshëm. Për të pasur një përfshirje sa më të gjerë dhe për të marrë mendimet e komunitetit dhe shoqërisë civile, janë organizuar edhe debate publike dhe debate në media.

Dokumenti i është paraqitur Kuvendit Komunal të Deçanit dhe është miratuar prej tij më 08.06.2012, duke e kthyer atë në një dokument zyrtar pune.

### **Procesi themelor i hartimit të PLVM-së ndahet në faza, të cilat lidhen njëra pas tjetrës:**

- a) Nënshkrimi i marrëveshjeve të mirëkuptimit në mes të REC – Komunë;
- b) Aktivitetet përgatitore;
- c) Formimi i trupit koordinues TK;
- d) Formimi i grupit punues GP;
- e) Trajnimi i anëtarëve të GP;
- f) Vizionimi i komunitetit;
- g) Vlerësimi i gjendjes së mjedisit;
- h) Anketimi i qytetarëve;
- i) Caktimi i prioriteteve;
- j) Hartimi i planit të veprimit për fushat prioritare dhe;
- k) Caktimi i prioriteteve në realizimin e planit të veprimit.



Dokumenti është i hartuar mbi tri baza kryesore:

### **1. Analiza e gjendjes mjedisore**

Paraqet një analizim të hollësishëm të situatës për të gjitha çështjet e marra në konsideratë nga plani, duke e paraqitur atë në të gjitha aspektet e tij dhe të ndërlidhura ndërmjet tyre. Kjo analizë shërben për të pasur një ide më të qartë të problemeve mjedisore, të cilat shqetësojnë Komunën e Deçanit.

### **2. Lista e problemeve mjedisore**

Problemet mjedisore paraqiten sipas një matrice të paracaktuar, e cila jep në mënyrë të detajuar të gjithë treguesit për identifikimin e një problemi. Pjesët më të rëndësishme të kësaj matrice janë shkaktarët e problemit dhe prioriteti për secilin.

### **3. Plani i veprimeve për zgjidhje**

Ky kapitull është pjesa më e rëndësishme e Planit, pasi paraqet të gjitha veprimet dhe projektet e mundshme për zgjidhjen e problemeve mjedisore të përcaktuara.

Kjo matricë u shërben autoriteteve vendore për të hartuar projektet konkrete dhe për sigurimin e fondeve nga donatorët.

# VIZIONI

*“Deçani udhëkryq i lidhjes lindje-perëndim, qendër rajonale për eko-turizëm, mbrojtje dhe ruajtje të mjedisit, si dhe vlerave të trashëgimisë natyrore dhe kulturore”.*

---

Sqarim për Vizionin: Deçani më infrastrukturë rrugore të integruar, do të jetë një ndër udhëkryqet që do të lidhë lindjen me perëndimin, krijimi i trekëndëshit lidhës Deçan-Aeroporti i Gjakovës- Brezit Kufitar. Më begatitë natyrore dhe pozitën gjeografike do të shndërrohet në qendër logjistike rajonale për turizmin, e gjithë kjo ndërlidhet më ndërtimin e rrugës Deçan-Plavë, e cila i mundëson një zhvillim të qëndrueshëm në drejtim të mbrojtjes së vlerave natyrore dhe trashëgimisë kulturore, po ashtu edhe kultivimin e tyre. Kjo rrugë i mundëson Deçanit qasje më të afërt me dy shtete, atë të Malit të Zi dhe Shqipërisë.

## Pjesa 2

### I. ANALIZA E GJENDJES MJEDISORE

Gjendja e mjedisit paraqet situatën e tregueseve të komponentëve kryesor të mjedisit, si: toka, uji, ajri, biodiversiteti etj. Veprimtaria e vazhdueshme e njeriut ka sjellë ndikim në këta komponentë, duke ndryshuar gjendjen e tyre natyrale. Në Komunën tonë, si pasojë aktiviteteve të ushtruara nga faktori njeri, janë dëmtuar në masë të madhe fondi pyjor, degradim i lumenjve dhe brigjeve të tyre, sipërfaqet e gjelbëruara nga hedhja e mbeturinave etj.

Gjendja e “Lumëbardhit” të Deçanit dhe “Lumëbardhit” të Lloqanit nuk është aq e mirë, nga shfrytëzimi pa kriter i rërës dhe i zhavorrit, i hedhjes së mbeturinave, derdhja e ujërave të ndotura (zeza) kanë ndikuar në cilësinë dhe sasinë e ujit. Mbeturinave të hedhura përgjatë - lumenjve, prrojeve, prrockave, kanaleve të ujitjes, si dhe depozitimi i tyre ndikon në ndotjen e tyre, po ashtu shfaqjen e dukurive si, erozioni dhe vërshimet në tokat bujqësore, që shtrihen përgjatë këtyre lumenjve. Burim kryesor në ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore në Komunën tonë janë mungesa e sistemit të kanalizimit për ujërat e ndotura (zeza), në pjesën urbane, ashtu edhe në pjesën rurale. Në gjithë pjesën rurale mungon sistemi i kanalizimit, ujërat e ndotura grumbullohen në gropat septike, të cilat nuk janë të ndërtuar sipas kriteve të ndërtimit. Ato më shumë janë gropa grumbulluese, që mund të ndikojnë në ndotje të ujërave nëntokësore, por edhe në ato sipërfaqësore. Problemi më serioz është në ato fshatra që kanë mungesë të rrjetit të ujësjellësit dhe furnizimi me ujë të pijshëm bëhet nga pusët. Largësia e stallave të kafshëve, mbeturinat organike, nuk janë aq larg nga pusët, të cilat mund të ndikojnë në cilësinë e ujit të pijes. Kanalizimi për ujërat e ndotura, në pjesën urbane faza e parë e tij ka përfunduar, në të përveç Deçanit janë të kyçura edhe këto fshatra: Carrabregu i Epërm, Carrabregu i Ultë, Belegu, Llukë e Epërm, Llukë e Ultë dhe Lumëbardhi.

Gjithashtu, administrimi i dobët i mbeturinave ka bërë që ndikimi në mjedis dhe në shëndetin e njeriut janë të konsiderueshme, të pranishëm edhe në komponentët kryesor të mjedisit (tokës, ujit, ajrit dhe biodiversiteti). Deponitë ilegale të mbeturinave paraqesin rrezik permanent për banorët e Komunës tonë. Gjithashtu, mbeturinat biodegradueshme përmes zbërthimit (dekompozimit) të tyre çlirojnë në ajër gazra të dëmshme, si CH<sub>4</sub> (metan) dhe CO<sub>2</sub> (dyoksid i karboni). Mirëpo, problemi më i madhe në deponitë ilegale janë zjarret e pakontrolluara, të cilat çojnë në lirim të gazrave toksike (dioksinë) të dëmshme për mjedisin, por edhe për shëndetin e njeriut. Është i domosdoshëm riciklimi i mbetjeve është ndarja e tyre në burim, i cili duhet të fillojë që nga mbledhja e mbeturinave nga ekonomitë shtëpiake. Caktimi i deponimeve lokale për mbeturina inerte (ndërtimet dhe prishjet), do të mundësojë menaxhim më të mirë të tyre. Nuk ka trajtim për mbeturinat e rrezikshme, insinerator për djegjen e mbeturinave spitalore (qendrave të mjekësisë familjare). Këto mbeturina depozitohen bashkë me mbeturinat urbane. Sasia e mbeturinave urbane për kokë banorit është 0.30 kg mbetje për banorë.

## 1. TË DHËNAT E PËRGJITHSHME PËR DEÇANIN

Deçani apo Ulëza e dikurshme është vend i banuar, që nga kohërat e lashta. Territori i sotëm i Deçanit ishte i banuar nga fiset Ilire, gjegjësisht fisi Dardan. Kosova në kohët e lashta quhej Dardani. Gjurmët e autoktonisë dhe pranisë së dardanëve në trevën e Komunës së Deçanit, sikurse edhe në trevat e tjera të Kosovës janë etnografike, kulturore, historike, toponimike, topografike, arkeologjike dhe antropologjike. Të gjithë pushtuesit e këtyre trevave vendosen sistemin e tyre administrativo-territorial, të cilin përshtateshin sipas interesave të veta, si: romakët, bizantinët, osmanët, austro-hungarezët, serbët, malazezët etj. Kjo trevë në kohën e sundimit osman ishte në kuadër të Sanxhakut të Dukagjinit me qendër në Pejë.

Shënimet e para të shkruara në të cilat përmendet Deçani dhe disa fshatra të tij, janë mjaft të vjetra, ato datojnë që nga gjysma e parë e shek. XIV. Këto dokumente quhen “krisobula”. Në këto dokumente Deçani përmendet në krisobulën shek. XIV. Në këtë periudhë, Manastirit të Deçanit i kanë takuar 40 fshatra me 2432 shtëpi. Kisha e manastirit të Deçanit është vepra më e madhe, që ruan elemente nga ndërtimtaria shqiptaro-dalmate, e ardhur nga bregdeti.

Të dhënat e burimeve historike të shekujve XV dhe XVI, duke dëshmuar se këto troje kishin shumicën dërmuese popullsi shqiptare. Treva e Deçanit, sikurse edhe tërë Kosova, ishte nën sundimin osman. Vlen të theksohet rezistenca e këtij popullit në fund të shekullit XIX dhe fillim të shekullit XX mbështetjen që i ka dhënë kësaj rezistence këtë e dëshmon edhe lidhja e Besës Komëtare të Verrat e Llukës, në Llukë të Epërme, në mars të vitit 1910.



Foto 1 dhe 2. Deçani dikur dhe tani

Në fillim të Luftës së Parë Botërore, kah fundi i vitit 1915, në këto treva u vu administrata austro-hungareze, e cila zgjati deri në vitin 1918, më largimin e tyre u vendos pushteti serbo-malazez. Deçani në atë kohë ishte në kuadër të Rrethit të Pejës dhe atë Gjakovës. Më ndryshimet administrative, territoriale në vitin 1929, trevat e Komunës së Deçanit ishte në kuadër të Banovinës së Zetës (Malit të Zi).

Në kohën e Luftës së Dytë Botërore, treva e Deçanit ishte në kuadër të zonës italiane, deri në vitin 1943, e pas kapitullimit italian ishte nën sundimin gjerman. Komuna e Deçanit formohet si Komunë në vitin 1963 me ndryshimet kushtetuese dhe quhet Kuvendi i Komunës së Deçanit. Në vitin 1989 u bë suprimimi i organeve të Kuvendit të Komunës së Deçanit u vendos administrimi i dhunshëm serb. Mirëpo edhe Deçani sikur të gjitha komunat tjera funksionoi si organ paralel në kuadër të Republikë së Kosovës.

Pas përfundimit të luftës së armatosur më pushtetin serb, në vitin 1999 në Kosovë u vendos Administrata e Kombeve të Bashkuara dhe më pas u bë konstituimi i organeve komunale. Komuna e


Deçanit u krijua, si njësi territoriale – administrative, sipas dispozitave të Rregullores për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës më nr. 2000/45.

Vendbanimet në të kaluarën kryesisht kanë qenë fshatrat me kulla të cilat janë ndërtuar, në radhë të parë, për të banuar në to, së dyti për t'u mbrojtur nga sulmet e armikut. Karakteristikë për rrethinat e Deçanit janë edhe vendbanimet që ndërtohen gjatë stinës së verës, në bjeshkët e këtyre anëve të ashtuquajtur tëbanat (stane). Këto janë vendbanime sezonale që shfrytëzohen për kullotje banim, në periudhën e verës, kur mbarshtrrohet bagëtia, si veprimtari dhe ekzistencë, në bjeshkët e kësaj treve.

### 1.1. Pozita gjeografike

Komuna e Deçanit shtrihet në pjesën perëndimore të Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit dhe pothuajse gjendet në qendër të Ballkanit, në vijën ajrore është larg nga Deti Adriatik 90 km, kurse 220 km larg nga Deti Egje. Drejtimi i shtrirjes së territorit të Komunës së Deçanit është veri-perëndim - jug-lindje në mes gjatësisë lindore: 20° 5' e 20" dhe 20° 32' e 8" dhe në mes gjatësisë veriore: 42° 33' e 30" dhe 42° 26' e 3" dhe sipas Sistemit Global të Pozicionimit: Veri - 47° 00' dhe 47° 20' dhe Lindje - 20° 52' dhe 20° 06'.

Në perëndim kufizohet me Republikën e Shqipërisë në gjatësi prej 5.5 km ndersa në veri-perëndim kufizohet më Malin e Zi 12.5 km. Në veri kufizohet më Komunën e Pejës: PT-2424 deri 460 (Maznik) më gjatësi prej 38.5 km . Në jug-lindje kufizohet me Komunën e Gjakovës nga PT - 460 deri të Gunga e Hereqit - në Jug nga PT 489 me gjatësi prej 24.05 km. Në jug dhe perëndim kufizohet me Komunën e Junikut 24. 35m .



**VËREJTJE:**  
Ndarja territoriale me Komunën e Junikut ende konsiderohet të jetë diskutabile, për shkak të nuk është zyrtarizuar ekzakt shtrirja e kufirit në mes të këtyre dy komunave.

Figura 1: Harta territoriale e Deçanit

Komuna e Deçanit ka një sipërfaqe prej 288.40 km<sup>2</sup> ose 28.840 ha nga e cila janë:

- 8.940,4 ha tokë pjellore;
- 14.420 ha pyje dhe;
- 5.479,6 ha kullosa.

Ka një qendër administrative (Deçan), 10 - të zyra të vendit dhe 37 fshatra, (Deçan, Carrabreg i Epërm, Carrabreg i Ultë, Lluka e Epërme, Beleg, Dranoc, Voksh, Lloqan, Hulaj, Sllup, Prejlep, Pobergjë, Irzniq, Kodrali, Pozhar, Lluka e Ultë, Lumëbardhi, Dashinoc, Vranoc i Vogël, Maznik, Strellci i Epërm, Ratishë i Ultë, Ratishë e Epërme, Glllogjan, Shaptej, Dubravë, Gramoçel, Baballoq, Rastavicë, Prokolluk, Strellci i Ultë, Lëbushë, Isniq, Prapaqan, Dubovik, Papiq, Belle). Qyteti i Deçanit nga kryeqyteti (Prishtina) ka një largësi prej 90 km.

## 1.2. Relievi

Lartësia mbidetare varion nga 412 lmd, fshati Maznik deri 2530 m lartësi mbi detare në Marjash, që d.m.th. në saje të krijimit të reliefit Komuna e Deçanit ndahet në dy pjesë:

- Në ultësi që është pjesa e rrafshit të Dukagjinit dhe;
- Dhe në lartësinë që përfshin masivin e Bjeshkëve të Nëmura (Alpet Shqiptare).

Rrafshi i Dukagjinit është krijuar në periudhën gjeografike-neogjen. Nga lëvizjet tektonike krijohet një liqe, që përfshin tërë Rrafshin e Dukagjinit. Nga mesi i Lacerit, niveli i ujit të liqenit fillon të ulët dhe më vonë, fillon të tërhiqet përmes luginës të Drinit të Bardhë. “Bjeshkët e Nemuna” apo Alpet Shqiptare shtrihen në pjesën perëndimore të Komunës së Deçanit dhe vazhdojnë me Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë Shkodrën, Tropojën, mandej në Mal të Zi: Plavën, Gucinë, Luginën e Ibrit, deri në Mokna, me një sipërfaqe prej 3500 km<sup>2</sup>.



Foto 3 dhe 4. Bjeshkët e Nemuna

Lartësia e “Bjeshkëve të Nemuna” pak ndryshojnë nga lartësia e vargmaleve alpine. Këto janë pjesët më të larta dhe më shkëmbore të vargmaleve të siujdhesës Ballkanike, me ç’rast shkëmbinjtë e bardhë dhe të dhëmbëzuar formojnë pamje imponante.

## 2. 3. Klima

Karakteristikat klimatike të Deçanit janë të njëjta, pothuajse në tërë territorin e Rrafshit të Dukagjinit. Deçani ka klimë kontinentale me ndikim të asajë mesdhetare. Gjatë vitit në Deçan ka 1.975 orë me diell. Viset e ulëta të Deçanit karakterizohen më temperatura relativisht të larta, më vlerë mesatare vjetore mbi 110C, me muajt më të nxehtë gushtin dhe korrikun 21,70 C dhe 21,680 C dhe me muajt më të ftohtë, janarin me -0,5 0 C. Në klimë ndikon shumë afërsia “Bjeshkëve të Nemuna” dhe rrymat e tjera të ajrit, që në viset e ulëta karakterizohet më vera të nxehta dhe të thata dhe më dimra relativisht të ftohtë dhe më lagështi.

Lagështia mesatare e ajrit gjatë vitit është 70,2 %, në të cilën rast rritja është dukshëm më e madhe prej verës kah dimri për 17,5 %, se sa zvogëlimi prej dimrit në drejtim të verës. Në këtë rajon vranësirat mesatare vjetore janë 58 %, gjatë së cilës frekuenca e ditëve të kthjellëta është 60,5 (16,6 %) në vit, ndërsa e ditëve të vrerta 119,3 ditë (32,6 %). Zgjatja mesatare vjetore e zënies së diellit për shkak të ndikimeve orografike është më e vogël se sa mesatarja për Kosovën dhe është 1.972 orë nga e cila në korrik 293, 6 orë ose 72,1 % diell në vit. Sasitë e të reshurave janë ndër më të mëdha të Kosovës. Në viset e ulëta është 724,6 mm, në viset malore sasitë mesatare të reshurave arrin më tepër së 1.300 mm.



Foto 5 dhe 6. Bjeshka e Belegut

Gjatë dimrit trashësia e borës në viset kodrinore-malore arrin deri më 50 cm, kurse në viset më të larta (bjeshkë) ajo është mbi 1m, kurse në lartësitë e mëdha malore (alpine) qëndron gjatë tërë vitit. Andaj, kushtet e këtylla klimatike mundësojnë zhvillimin e aktiviteteve rekreative sportive (skijimin) gjatë zezonës së dimrit. Shi bie më së shumti në pranverë dhe vjeshtë edhe atë mesatarisht 900-1500mm. Shpejtësia mesatare e erës gjatë vitit është 16 m/sek., ndërsa ajo maksimale arrin deri më 26,5 m/sek. Më së shpeshti era fryn nga veriu dhe veriperëndimi. Elementet kryesore klimatike që i përkasin Komunës sonë janë: moti i kthjelltë, lartësia e lartë mbidetare e kompleksit të bjeshkëve, temperatura të freskëta gjatë verës dhe mjaft të ftohta gjatë dimrit, reshjet atmosferike (dëborë) të bollshme, të ujërave në sasi të mjaftueshme.

## 1.4. Popullsia

Deçani në gjendjen e lëvizshmërisë demografike, si edhe komunat të tjera ka një dallim nga mesatarja në nivel të Kosovës. Gjendja shikuar në periudhën 1948-1981 është me disa dallime nga ajo e Kosovës. Sipas regjistrimit të vitit 1948 në Komunën e Deçanit kishte 39 vendbanime, 2794

ekonomi familjare me 20672 banorë. Sipas regjistrimit të vitit 1953, në kuadër të Rrethit të Pejës, bënin pjesë Këshilli Popullor i Komunës – Strellc i Epërm.

Deçani më 10 fshatra, 874 shtëpi ka 6.834 banorë. KPK i Irzniqit me 16 fshatra, me 786 familje dhe me 5865 banorë. Sipas shënimeve të përpunuara Komuna e Deçanit kishte 39 vendbanime me 2.912 ekonomi familjare me 22218 banorë. Bazuar në regjistrimet e vitit 1961, Komuna e Deçanit kishte këtë strukturë: Vendbanimet 39, ekonomi familjare 3386 dhe 25582 banorë. Nga ky numër 22472 ose 87.8 % ishin shqiptarë, 413 ose 1.6 % serbë, 2534 ose 9.9 % malazezë, 51 ose 0.2 % myslimanë, 6 turq ose 0,5 %.

Sipas regjistrimit të vitit 1971, Komuna e Deçanit kishte 39 vendbanime me 3.975 ekonomi familjare me 31335 banorë, nga të cilat 29474 ose 94.2 % shqiptarë, 310 ose 1.0 % serbë, 1357 ose 4.3 % malazezë, 133 ose 0.4 %, myslimanë. Sipas regjistrimit të vitit 1981, Komuna e Deçanit kishte 40 vendbanime me 40640 banorë, nga të cilat 39179 ose 96.4 % shqiptarë, 234 ose 0.6 % serbë, 898 ose 2.2 % malazezë, 217 ose 0.5 %, myslimanë, 112 ose 0.3 % të tjerë.

Sipas regjistrimit të vitit 2011 rezultate preliminare, numri i banorëve në Komunë është 40.168, ndërsa i ekonomive familjare 6.141 dhe madhesi mesatare prej 6 anëtarve. Struktura gjinore është meshkuj 20.088 dhe femra 20.080. Pas lufte ekziston një migrim i banorëve nga fshati në qendrën urbane dhe jashtë shtetit.

## 2. PASURITË NATYRORE

### 2.1. Mineralet

Pasuritë minerale, përveç tokës, fondit të pyjeve dhe ujit, janë mjaft të kufizuara, vlerësimi i kushteve gjeologjike varet kryesisht nga shkalla e hulumtimit të pasurive minerale. Më i përhapur është guri gëlqeror, por nuk shfrytëzohet aq shumë, rëra dhe zhavorri është shumë i përhapur në shtretërit e lumenjve, gjithashtu i përhapur është guri i mermerit, që gjendet në Grykën e Deçanit. Meqë hulumtimet po bëhen vazhdimisht, mund të priten informacione të sakta nga hulumtimet e reja.

### 2.2. Pyjet

Ndër pasuritë natyrore të Deçanit, pyjet zënë vend me rëndësi dhe kanë vlerë të çmueshme. Përveç rëndësisë ekonomike, pyjet kanë rëndësi dhe ndikim të madh edhe në funksionin natyrorë mbrojtës: klimë, ajër, ujë, tokë, konservim të trashëgimisë biologjike dhe funksionin social-kultural, siç janë: turizmi, rekreacioni dhe shumë funksione të tjera. Sipërfaqet pyjore në Komunën e Deçanit janë, si vijon: sipërfaqja e përgjithshme 14420 ha, prej tyre pyje shoqërore/shtetërore 10144 ha dhe private është 4276 ha.

Rritja vjetore është 92,691 m3, kualiteti i masës drunore është i nivelit të lartë ku 70 % është dru teknik, i cili përdoret për përpunimin e mëtutjeshëm në industri.

Një nga qëllimet kryesore duhet të jetë zhvillimi i fondit pyjor, përmes:

- Pyllëzimit të sipërfaqeve të zhveshura;
- Shndërrimit gradual të shkurreve në pyje të rregulluara;
- Shndërrimi gradual (natyror, artificial) të pyjeve të ulta në të mesme dhe në të larta dhe;
- Kultivimi intensive të pyjeve të larta të ruajtura.



Pyjet janë ekosisteme në të cilat rriten një numër i madh i llojeve bimore dhe shtazore me rëndësi ushqyese dhe mjekësore për njeriun. Ato përveçse pengojnë erërat e fuqishme janë edhe ambient çlodhës për njeriun. Pyjet, po ashtu, janë akumuluesit më të mëdhenj të sasisë së CO<sub>2</sub> në tokë dhe furnizuesit kryesorë të atmosferës me oksigjen. Janë resurse natyrore ripërtëritëse, produktet e të cilave mund të shfrytëzohen në industri, për djegie dhe për qëllime të tjera. Asgjësimi dhe degradimi i pyjeve është parakusht i parë i paraqitjes së ndryshimeve të padëshiruara në natyrë, gjë që negativisht manifestohet në kushtet e jetesës, ekonomizimit, madje edhe në interesin e përgjegjshëm të popullatës. Pyjet duhet të qeverisen në bazë të planeve pyjore-ekonomike. Prerja e pyjeve duhet të silltet në kufij të lejueshëm/përkatës, të cilët do të sigurojnë drejtpeshimin në mes të rritjes së masës drunore, respektivisht, të sigurojnë drejtpeshimin në mes të rritjes dhe prerjes. Përveç kësaj, nevojitet që vazhdimisht dhe sistematikisht të ndërmerren masa në punët kultivuese-pyjore për përtëritjen dhe ruajtjen e tyre. Kujdesi ndaj pyjeve dhe përdorimi racional i pyjeve janë bazë për zhvillimin afatgjatë të pylltarisë.

#### REKOMANDIME:

- Monitorimi i pyjeve në aspektin e prerjeve ilegale dhe implementimi i ligjit;
- Pengimi i prerjeve, uzurpimeve dhe aktiviteteve ilegale;
- Ndërgjegjësimi i popullsisë për ruajtjen e pyjeve dhe;
- Pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura.

### 2.3. Toka bujqësore

Komuna e Deçanit disponon me 8940.4 ha tokë bujqësore, që përfshinë 31 % të sipërfaqes së tërësishme të Komunës së Deçanit (28.840 ha). Kjo sipërfaqe e tokës bujqësore në bazë të cilësisë e ndarë në kategori/klasa dhe e shprehur në përqindje është, si vijon:

• Tokë e mirë	klasa	I,II,III	60 %
• Tokë e mesme	klasa	IV	25 %
• Tokë e varfër	klasa	V,VI	15 %

Nga kjo sipërfaqe 8940.4 ha, 8180,4 ha janë në pronësi private dhe 760 ha janë në pronësi shoqërore, (më të cilën menaxhon Agjencioni Kosovar i Privatizimit (AKP) dhe janë në proces të privatizimit). Në mungesë të mbrojtjes institucionale, humbja e tokës bujqësore manifestohet në forma të ndryshme. Humbjet e përhershme të tokës bujqësore: vendbanimet/urbanizimi, veprimtarit komerciale, bizneset e ndryshme etj. Humbjet e përkohshme të tokës bujqësore: mihjet sipërfaqësore, eksploatimi i rërës dhe zhavorrit, argjilës, mbeturinat, deponitë ilegale (të egra), procesi i erozionit, degradimi, gërryerjet e lumenjve etj. Tokat e klasës së I, II, III, dhe të IV janë tokat të mbrojtura me ligjin mbi tokat bujqësore.

#### REKOMANDIME

- Përpilimi i katastrit të tokave bujqësore;
- Mbrojtja e tokave bujqësore nga ndërtime të egra;
- Zgjerimi i qytetit të racionalizohet me ndërtime të larta-banime kolektive;
- Të bëhet komasacioni apo rregullimi i tokave,
- Rregullimi i infrastrukturës nëpër zona rurale do t'i kontribuonte zhvillimit të bujqësisë, pengimit të migrimit të popullsisë fshat-qytet;

- Vetëdijesimi i popullsisë për rëndësinë e mbrojtjes të tokës bujqësore;
- Parandalimi i mëturjes së tokës nga ndotësit (mbeturinat);
- Rikultivimi, mbrojtja dhe shfrytëzimi i tokave, dhe;
- Zbatimi i dënimeve rigoroze, për mosrespektimin e rregullativës ligjore për mbrojtjen e fondeve tokësore.

## 2.4 Tokat erozive

Kjo dukuri në Komunën tonë është prezent në viset malore dhe përgjatë lumenjve. Si pasojë e faktorëve natyrorë, siç janë: kushtet klimatike, përbërja litologjike e korës së tokës, pjerrësia e terrenit, shpejtësia e rrjedhjes së ujit, kanë ndikim në shfaqjen e proceseve erozive. Gjithashtu, veprimet e shkaktuara edhe nga faktori njeri si: shpyllëzimi, dëmtimi i brezit mbrojtës përgjatë lumenjve, mbeturinat, eksploatimi i rërës dhe zhavorrit, rritja e sipërfaqes së urbanizuar dhe veprimet e tjera, kanë ndikuar në rritjen e shkallës së erozionit.

Janë dy periudha kohore ose stinë të vitit, që karakterizohen më vërshimet: Stina e dimrit/pranverës për shkak të reshjeve të shumta të borës dhe shiut, dhe stina e vjeshtës për shkak të reshjeve të shumta të shirave.

Pothuajse të gjitha fshatrat e Komunës së Deçanit, pak a shumë, janë të prekura nga rreziku i vërshimeve, qoftë atyre pas stuhisë në zonat malore, atyre pas shirave të vazhdueshme në zonat fushore apo vërshimeve pas shkrirjes së borës të shoqëruara më mot të ligë.

Vendet më të rrezikuara nga erozioni dhe vërshimet në Komunën tonë janë:

**Lumi i Lloqanit** që kalon në këto lokalitet duke shkaktuar zona vërshuese-Fushat në lindje të Prejlepit, Rastovicës, fusha Devoll e fshatit Baballoq, lagjet Regjaj dhe Mushkolaj në fshatin Gramaqel dhe Jasiq i Ri, nga ku pastaj kalon në fshatrat e Komunës së Gjakovës.

**Lumbardhi i Deçanit** - Nga Ura e Demës, duke përfshi fushat në veri të Deçanit, Llukë e Epërm dhe Ultë, Lumbardhë, Kotradiq dhe Vranoc.

**Prroni i Behovcit** - Nga lagja Hajrizaj vazhdon të Zalli Strellcit, Isnij (Lagja Bruqëve) dhe fshati Dubovik.

**Prroni i Durakuat** - Pjesën veriore të fshatit Strellc i Epërm, pastaj aksi i magjistrales Strellc-Lubeniç.

### REKOMANDIME:

- Parandalimi i prerjes dhe degradimit të pyjeve;
- Parandalimi i kullotjes së tepërt;
- Parandalimi i shfrytëzimit joracional të resurseve natyrore që mund të shkaktojnë erozion dhe;
- Krijimi i pendëve mbrojtëse.

### 3. BURIMET UJORE

Territori i Komunës së Deçanit shtrihet në pellgun e dy lumenjve, të cilët burojnë në masivin e “Bjeshkëve të Nemuna”, të cilët kanë burime të shumta të ujit. Të gjithë lumenjtë, që përshkojnë territorin e Komunës së Deçanit burojnë në lartësinë e “Bjeshkëve të Nemuna”, dhe të cilat derdhen në Drinin e Bardhë, që është ujëmbledhës dhe derdhen në Detin Adriatik. Lumenjtë që burojnë dhe përshkojnë territorin e Komunës janë:

#### 3.1 Lumëbardhi i Deçanit

Më gjatësi 40,5 km buron në Bjeshkën e Roshkodolit në vendin e quajtur, Tëdel i Lumëbardhit në lartësi 2130m. Pellgu i tij përshkon fshatrat: Deçan, Isniq, Llukë e Epër dhe Llukë e Poshtëm, Lumbardhë dhe Broliq, fushat e të cilave fshatra i ujit, si dhe furnizon me ujë liqenin akumulues të Radoniqit.

Shtrati Lumëbardhit duhet të rregullohet në tërësi nga Manastiri i Deçanit e deri në fshatin Lumbardhë me gjerësi prej 50 metrash në të dy anët e lumit. Ky rregullim i lumit në të dy anët e lumit, që do të marrin funksionin e shëtitoreve.



Foto 7. Lumëbardhi i Deçanit

### 3.2. Lumëbardhi i Lloqanit

Më gjatësi 23,7 km që buron nga shpatijet e Kurvallës, Dervishë-Komit dhe të Stanishtës së Zogut në lartësi mbi detare 2100m. Pellgu i Lloqanit përshkon fshatrat Hulaj, Lloqan, Carrabreg i Epër, Prejlep, Rastovicë, Baballoq, Gramaqel. Ky lumë përveç që ujit fushat e këtyre fshatrave, uji i tij përdoret për ujitje të fushave edhe të shumë fshatrave të tjera si: Pobërgjë, Voksh, Sllup, Dranoc etj. Shtrati dhe brigjet lumit janë pjesërisht të rregulluara.

Në lumenjtë që përshkojnë territorin Komunës sonë, në ta ekzistojnë kushte shumë të volitshme për kultivimin dhe rritjen e peshkut dhe ndërtimin restoranteve dhe hoteleve që do të kishte efekt shumë pozitiv socio-ekonomik dhe turistik. Potenciali ujqor i “Bjeshkëve të Nemuna”, në masë të madhe është i grumbulluar nëpër rezervuare, prej nga distribuohet si ujë i pijshëm nëpër ujësjellës të vendbanimeve dhe shfrytëzohet nga qytetarët për pije. Pjesën tjetër popullata e shfrytëzon për ujitje të sipërfaqeve bujqësore. Mirëpo, shtretërit e lumenjve janë të parregulluar që periodikisht vërshojnë tokat bujqësore dhe dëmtojnë mbulesën vegetative. Pellgjet e tyre janë të ekspozuara proceseve erozive dhe vërshuese.

Territorin e Komunës së Deçanit e përshkojnë edhe një numër i konsiderueshëm i projeve dhe prrockave si: Përroi Durakut i Strellcit, Përroi i Behovcit, Prrojet e Vokshit, Përroi i Glllogjanit, Përroi i Lëbushës dhe Përroi i Ratishit.

Në lartësinë e bjeshkëve ekziston një numër madh i liqeneve me origjinë glaciale të njohur në gjuhën popullore si “sytë e maleve”. Këta liqe janë burimet kryesore të vlerave mjedisore, turistike dhe ekonomike për Komunën tonë. Liqet natyror që gjenden në masivin e “Bjeshkëve të Nemuna” paraqesin habitat për interes të veçantë për zhvillimin e turizmit, por nuk janë aq shumë të hulumtuar.

### 3.3. Uji mineral

Ujërat minerale dhe termale ndeshen në katër lokalitet të Rrafshit të Dukagjinit, ku një nga këto burime më i njohuri është ai i ujit të thartë afër Manastirit të Deçanit. Për shkaqe të shpalljes së asaj pjese si zonë të rëndësisë së posaçme, në të cilin gjendet burimi. Ajo pjesë ka mbetur pa një infrastrukturë të rregulluar turistike, si dhe nuk ka qenë i mundur shfrytëzimi komercial i këtij burim. Gjendja e tanishme e burimit nuk ofron kushte për eksploatimin tij, si dhe për vizitorët. Në të ardhmen, mendohet rregullimi i infrastrukturës për këtë burim, si dhe mundësia e hapjes së ndonjë reparti për mbushjen e shisheve më ujë në afërsi të burimit, duke i ditur edhe cilësitë e tij të ndryshme shëndetësore.

## 4. EKONOMIA

Potencialin ekonomik në Komunën e Deçanit e përbëjnë: ekonomitë vogla-fermat e private të blegtorisë, bujqit individual, tregtarët, zejtarët (zdrukthëtarët, sharrat) etj. Gjendja socio-ekonomike i ka këto parametra: 40168 banorë, 284.4 km<sup>2</sup> ose 28440 ha, ose 141 banorë në km<sup>2</sup>. Nga numri i përgjithshëm i popullsisë së aftë për punë, janë punësuar vetëm 37 %. Pjesa prej 63 %, çdo ditë ballafaqohen me probleme themelore ekzistenciale, të cilat dita-ditës bëhen edhe më të rënda.

### 4.1. Punësimi

Shkalla e lartë e papunësisë është një ndër problemet dhe sfidat kryesore të zhvillimit të ardhshëm të Deçanit. Shkalla e papunësisë është përlogaritur dhe sillet prej 63 %. Si problem mjaft i madh në Komunë paraqitet numri i madh i të papunëve nga popullsia e aftë për punë, për të cilët është e nevojshme që të gjenden (tërhiqen) investitorë potencial, të cilët do të investojnë në ndërmarrje të vogla dhe të mesme.

Papunësia (Shënimet nga enti për punësim. Shiko tabelën statistikore)

Tabela 1. Statistikat për të papunësuarit

Nr.	Papunësia në vitin 2012	8010
1	Meshkuj	4755
2	Femra	3255

Ajo që shqetëson më shumë është numri i madh i punëkërkuesve, sidomos të rinjve dhe atyre me kualifikime të mesme dhe të larta, që janë mbi 2988.

### 4.2. Barazia gjinore

Barazia gjinore u referohet të drejtave, përgjegjësisë dhe mundësisë të barabarta burrave, grave, vajzave dhe djemve në një shoqëri. Në Komunën Deçanit kësaj çështje i është kushtuar rëndësi e veçantë, sidomos në politikat e punësimit dhe përfaqësimit të gruas në të gjitha sferat e jetës. Sipas të dhënave të nxjerra nga Enti për Punësim i Komunës, në administratën publike janë të punësuar 134 punëtorë, prej tyre, femra janë: 27, ndërsa meshkuj janë: 107.

Në sektorin e arsimit, numri i të punësuarve dhe përfaqësimi gjinor është si vijon: mësimdhënës të gjinisë femërore janë:184, ndërsa meshkuj janë: 394.

Në shëndetësi: të gjinisë femërore janë: 84, ndërsa meshkuj janë: 36

Si pasojë e mundësisë së kufizuar për pjesëmarrje në organizmat vendimmarrëse, gratë dhe vajzat kanë arritur mundësi drejtuese nëpërmjet alternativave të tjera, në mënyrë të veçantë në sektorin jo-qeveritar. Në Komunën tonë, ato gjetën më shumë hapësirë dhe liri për një angazhim aktiv në dobi të çështjeve të grave/vajzave dhe fëmijëve në veçanti, por edhe të komunitetit në tërësi. Shoqatat e grave kanë arrit të realizojnë një sërë aktiviteteve lidhur me të drejtat e grave/vajzave dhe fëmijëve, përkujdesjen sociale e shëndetësore, zhvillimin ekonomik (kryesisht të biznesit të vogël) etj.



Foto 9 dhe 10. Aktivitete të OJQ “Jeta” - Deçan

#### REKOMANDOHEN:

- Rritja e numrit të projekteve apo programeve të cilat nxisin formimin profesional dhe punësimin e grave dhe vajzave, si dhe shtrirja e këtyre projekteve edhe në zonat rurale, dhe;
- Rritja e ndërgjegjësimit të shoqërisë për pjesëmarrjen aktive të grave dhe vajzave në vendim-marrje (politikë).

### 4.3. Industria

Sektori i industrisë është i dëmtuar që nga lufta dhe i njëjti nuk është në funksion. Do të kishte shumë rëndësi, që fabrikat e dikurshme, si: Fabrika auto-pjesëve “Ramiz Sadiku” në Isniq, e pompave me piston në Isniq, rrjetit të armiruar në Deçan, përpunimit të mjaltit “APIKO” në Deçan, fabrikat për përpunimin e drurit, mobileve po të funksiononin do të kishin efekt pozitiv në uljen e papunësisë. Disa nga këto objekte janë privatizuar sipas AKM-ës dhe funksionojnë shumë pak, duke mos ndikuar pothuajse aspak në uljen e papunësisë. Sipas Planit Zhvillimor Komunal, parku industrial është paraparë në hyrje të Deçanit nga magjistralja Pejë-Deçan në pjesën e majtë, ndërsa kategoria e tokës III-të, nuk ka ndikim në rrjedhat e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, sepse sipas planit në fjalë parashihet industri e lehtë.

### 4.4. Bujqësia

Bujqësia, si degë e rëndësishme e ekonomisë, ka një rëndësi të madhe për Komunën e Deçanit. Ekzistojnë kushte specifike të cilat favorizojnë bujqësinë e kësaj Komune për prodhimin e kulturave bujqësore të kualitetit të lartë. Prodhimtaria bujqësore është e orientuar në: prodhimtarinë bimë, blegtorale, shpeztari dhe bletari. Më bujqësi merret një numër i konsiderueshëm i popullsisë së Komunës së Deçanit, rreth 65 % dhe prej saj një pjesë e madhe popullsisë siguron ekzistencën e tyre. Në bazë të kushteve agroekologjike, nga agrikultura mund të arrihen edhe rendimente të kënaqshme dhe cilësore, si të kulturave lavërtaria, ashtu edhe prodhimeve blegtorale. Edhe pse ekzistojnë kushte të volitshme natyrore, zhvillimi dhe prodhimi i produkteve vendore të natyrës ushqimore janë të ulëta dhe shumica prej tyre vijnë nga importi, si: miell, qumësht, pemë, perime, vaji, mish, farorët etj. Komuna e Deçanit ka përparësi të mëdha për zhvillimin e bujqësisë, duke filluar nga: Kushtet agroekologjike mjaft të favorshme, resurset natyrore, toka, pasuritë ujore (lu-

menjtë) etj. Fuqia punëtore, me përvojë dhe e kualifikuar; shitja e produkteve të brendshme, si dhe mundësia për eksport. Krahas përparësive që ekzistojnë ka vështirësi në zhvillimin e bujqësisë:

- Sipërfaqja e tokës është mjaft e kufizuar-fragmentuar (mesatarisht 0.19 ha për kokë banori), me tendencë të zvogëlimit e cila ulë mundësin e konkurimit dhe;
- Mungon subvencionimi i prodhimit të bujqësore.

Sipërfaqja e përgjithshme /ha –me kultura bujqësore janë: 8.940,4 ha, ndërsa tokë e lërueshme është 5.916 ha. Kulturat kryesore janë: misri, gruri, pemët dhe perimet. Sipas mënyrës së shfrytëzimit me të mbjella mund të thuhet se kulturat e lavërtarisë kultivohen në sipërfaqe më të mëdha (afërsisht) më këtë strukture të mbjelljes<sup>1</sup>:

Ndërsa, kulturat industriale fare pak kultivohen si: duhani, panxhari, kolza, luledielli. Perimet në Komunën e Deçanit zënë një sipërfaqe prej afro 1600 ha. Me pemishte dikur kanë qenë të përfshira rreth mbi 1000 ha, të sipërfaqes të tokës së punueshme, ndërsa tani kjo sipërfaqe në formë të plantacioneve llogaritet afërsisht vetëm 790 ha, nga sipërfaqja e dikurshme e pemishteve. Sipërfaqja e tokës është e kufizuar, si dhe dita-ditës po zvogëlohen nga ndërtimet e egra. Në Komunën e Deçanit prioritet duhet dhënë: zhvillimit të blegtorisë, prodhimit të perimore, kultivimit të pemëve të ndryshme etj.

Infrastruktura ujitjes në zonat bujqësore është e nivelit të ulët. Kanë nevojë për përmirësimin dhe veprimin urgjent në rregullimin e kanaleve dhe vijave të ujitjes, si dhe në ndërtimin e një ujëmbledhësit në Grykën e Lloqanit, që do të ujitëshin rreth 4000 ha tokë punuese, do të ketë furnizim më ujë të pijshëm për disa fshatra dhe një mini-hidrocentral.

#### 4.5. Prodhimtaria perimore

Për Komunën tonë rëndësi ekonomike ka edhe ngritja e serave për kultivimin e perimeve. Për këtë qëllim sipërfaqet e rrafshta duhet të destinohen për ngritjen e serave duke pasur parasysh edhe kushtet e favorshme që krijon rrjedhat e Lumëbardhit të Deçanit dhe Lumëbardhit të Lloqanit, ku toka është më cilësore, si dhe afërsia me tregun-konsumatorin. Hapësirat adekuate për kultivimin e perimeve ekzistojnë në fshatrat: Isniq, Prejlep, Rastovic, Irzniq, Gllloqan, Baballoq, Gramaçel, kurse në Ratish, Maznik, Pobergjë, Vokshë, Dranoc, për kultivimin pemëve të imta etj. Rritja e kultivarve të ri dhe zgjerimi asortimenti të llojeve dhe kultivarëve të ndryshëm që sjellin përfitime më të mëdha ekonomike si dhe ngritja e kapaciteteve për konservimin dhe përpunimin e perimeve në afërsi të qendrave prodhuese janë të nevojshme.

#### 4.6. Zhvillimi i pemëtarisë

Hapësirat adekuate për ngritjen e plantacioneve ekzistojnë në pjesën bregore që shtrihen në: Deçan, Irzniq, Rastovicë, Beleg, Pobergjë, Voksh etj. Për zgjerimin e pemishteve duhet të realizohen edhe këto masa: Stimulimi i fermerëve për ngritjen e pemishteve, sigurimi i fidanëve cilësore me potencial të lartë prodhues dhe rezistencë nga sëmundjet ndryshme, të organizohen trajnime me fermerët për ngritjen dhe menaxhimin e pemishteve, zgjerimi i sistemit të ujitjes, ngritjen e depove bashkëkohore për ruajtjen e pemëve dhe përpunimin e tyre. Hapësirë adekuate për ngritjen e pemishteve ekzistojnë hapësirat e ish-kooperativave bujqësore në fshatin Rastovicë.

<sup>1</sup> Këto të dhëna ndryshojnë nga viti në vit.

## 4.7. Blegtoria

Blegtoria, si degë mjaft e rëndësishme e bujqësisë sonë, është një sektor shumë i rëndësishëm që në vazhdimësi po japë rezultate të mira në bujqësi, gjysmë komerciale të Komunës sonë. Në bazë të disa shënimeve llogaritet së në Komunën e Deçanit ekziston ky numër i kafshëve<sup>2</sup>:

Lopë qumështore - 12.000 krerë;

Viça - 4500 krerë;

Dele - 4000 krerë;

Qengja - 2300 krerë;

Kuaj - 860 krerë;

Derra - 680 krerë dhe;

Pula - 40.000.



Kushtet agroekologjike janë shumë të favorshme për një blegtori intensive më perspektivë të gjatë të zhvillimit. Këtë e mundësojnë edhe resurset e mëdha natyrore, që disponon Komuna e Deçani. Sipërfaqe të mëdha me kullosa natyrale (mbi 7,000.00 ha); tokë punuese prej 8940.4 ha, dhe resurse ujore në të gjithë territorin e Komunës bëjnë të mundur zhvillimin e blegtorisë. Zhvillimi i blegtorisë zhvillohet në pjesën e rrafshulëtave, por edhe në pjesën kodrinore malore duke shfrytëzuar sipërfaqet e konsiderueshme të kullosave dhe livadheve për prodhimin biologjik të prodhimeve blegtorale.

Përpunimi i produkteve blegtorale në Komunën tonë është me metodat të vjetra dhe bëhet vetëm në ekonomitë familjare (nuk kemi fabrika për përpunimin e produkteve blegtorale), ndërsa shitja e këtyre produkteve bëhet pa ndonjë organizim të veçantë.

Për sipërfaqe bujqësore të kultivuara në Komunën e Deçanit përdorimi i pesticideve është pothuajse i kufizuar, por megjithatë, gjënë përdorim në perimekultura dhe pemishte, ndërsa përdorimi i plehrave kimike pothuajse përdoret në disa sipërfaqe bujqësore dhe atë me doza mesatare 300-500 kg/ha, varësisht nga kultura bujqësore. Sipas të dhënave nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, nuk ka ndotje të ambientit nga përdorimi intensiv të tepruar të pesticideve (herbicideve, fungicideve, insekticideve) etj. Në të ardhmen bujqit duhet që të informohen më shumë për eko-bujqësinë, për llojet e reja të pemëve, perimeve etj., gjegjësisht bujqit të motivohen, që të prodhojnë prodhime ekologjike nëpërmes menaxhimit të integruar të dëmtuesve (IPM-MID). Informim i pamjaftueshëm për eko-bujqësinë ose bujqësinë organike.

### REKOMANDIME:

- Riaktivizimi i kooperativave bujqësore në bazë të procesit të ri të organizimit të kooperativave;
- Ngritja e serave për perime;
- Të riorganizohen trajnime për bletarët e rinj;
- Ngritja e plantacioneve: me dredhëza, manaferra, lajthi, mjedra, kumbulla, molla etj.;
- Ngritja e mini-fermave qumështore, vëçave për majmëri, mështjerrave për riproduksion, deleve etj.;
- Ngritja e fermave për pula dhe brojler;
- Ngritja e parkut të bletarisë dhe shtimi i numrit të shoqërive të bletëve etj.;
- Rregullimi i sistemeve të ujitjes (në serra preferohet ujitje pika-pika);
- Rritja e aftësive konkurruese përmes ngritjes së cilësisë dhe produktivitetit;
- Informimi dhe trajnimi i fermerëve nëpërmjet shërbimeve këshilluese të Kosovës.

<sup>2</sup> Këto të dhëna ndryshojnë nga viti në vit



#### 4.9. Energjia

Furnizimi me rrymë elektrike bëhet nga Korporata Energjetike e Kosovës. Njësia e KEK-ut në Deçan e bënë distribuimin (shpërndarje), mbikëqyrjen dhe menaxhimin e energjisë elektrike. Problemet të cilat ballafaqohen qytetarët janë: reduktimet e shpeshta të rrymës, tensioni i ulët, mundësojnë paraqitjen e defekteve të shumta, që manifestohen me dëme materiale për sektorin e banimit, ekonomisë, por edhe me humbje njerëzore (humane).

Në Komunë vepron edhe Hidrocentrali në Kozhnjeri “Lumëbardhi”, që prodhon afërsisht 8.4 MG/h rrymë. Konsumi i energjisë elektrike në Komunën e Deçanit gjatë viteve të ardhshme është në rritje, andaj është e domosdoshme të hartohen/ndërtohen projekte për ndërtimin e hidrocentraleve të tjera përgjatë “Lumëbardhit” të Deçanit etj. Në kohë sa më të shkurtër korporata energjetike distribuimi në Pejë duhet të intervenojë në drejtim të përmirësimit me furnizimi me energji elektrike kualitative të vendbanimet e komunës së Deçanit. (Rregullim infrastrukturës energjetike). Mirëpo, ka mbetur edhe një pjesë e madhe e rrjetit që në të ardhmen duhet riparuar, për arsye se është i vjetërsuar dhe sjellë probleme me furnizim me energji elektrike, sidomos gjatë stinës së dimrit për shkak të mbingarkesave që ka rrjeti.

#### 4.10. Turizmi dhe hoteleria

Perspektiva zhvillimore e Komunës së Deçanit është përqendruar në zhvillimin e turizmit, vetëm përmes turizmit mund të prezantohen dhe propagandohen vlerat e larta natyrore, konfiguracioni i relievit, kushte e përshtatshme klimatike-hidrografike, të mbajturit gjatë të borës dhe llojllojshmëria e florës dhe faunës, të cilat japin mundësi të jashtëzakonshme për zhvillimin e aktiviteteve të llojllojshme turistike e rekreative. Për zhvillimin e turizmit malor duhet që resurset natyrore të shfrytëzohen në mënyre racionale dhe të hartohen strategji zhvillimore, andaj zhvillimi i aktiviteteve turistike është i mundur në tri forma themelore:

1. Turizmi stacionar;
2. Vikend-turizmi dhe;
3. Turizmi transit.

“Bjeshkët e Nemuna”, dhe lokalitet e saj në kuadër të Komunës, ofrojnë kushte të favorshme për zhvillimin e turizmit rekreativ stacionar, dimëror dhe veror, të gjuetisë dhe të peshkimit, si dhe të turizmit për vikend. Këto male shquhen edhe me lugina të lumënjve dhe grykat, të cilat pos funksionit për komunikacion, kanë funksion turistik dhe rekreativ. Më peizazh të veçantë dhe të rrallë turistik është “Gryka e Deçanit” dhe “Gryka e Lloqanit”.

Kushte natyrore mundësojnë zhvillimin turizmit veror dhe dimëror. Turizmi dimëror zë një vend të



Foto 11. Bjeshkët e Nemuna



Foto 12. Lumëbardhi i Deçanit



Foto 13. Bjeshkët gjatë dimrit

rëndësishëm në zhvillimin e turizmit, duke pasur parasysh terren shumë të përshtatshme hapësinorë, natyrorë e klimatik për zhvillimin skitarisë, veçanërisht në “Bjeshkën e Belegut” dhe në “Bjeshkën e Kurvallës”. Sipas një studimi të bërë nga ekspertë kroatë, në vitin 1985 së terrenet në “Bjeshkën e Belegut” dhe “Bjeshkën e Kurvallës” kanë një hapësirë të favorshme për zhvillimin e turizmit dimëror. Projekti i hartuar për “Bjeshkën e Belegut”, si: zonë turistike-rekreative sportive për sportin dimëror, duhet të realizohet me arsyetimin se; nëpërmjet tij prezantohen vlerat ekologjike, shkencore, edukative-arsimore, sportive, shëndetësore-turistike me interes të gjerë shoqëror jo vetëm për Komunën, por edhe për regjionin, me vlera të larta ndërkombëtare. Për këtë duhet të bëhet sensibilizimi i vlerave turistike, që do të ketë tërheqjen e investitorëve për të investuar dhe realizuar projektin më profitabil ekonomik.

Këto vlera turistike paraqesin vlera tërheqëse, përveç atyre natyrore, paraqesin edhe përmendoret historike dhe kulturore. Ndër to shquhen kullat dhe manastiret mesjetare, monumentet e kulturës islame nga periudha turke, si dhe fragmente të ruajtura nga arkitektura folklorike. Ky rajon parqet, po ashtu, një muze të njëmendët etnik dhe ambient specifik edhe nga aspekti etnologjik dhe elementeve folklorike: veshje, loje, këngë dhe doke. Disa nga shtëpitë e vjetra (kullat e restauruara) me arkitekturë të përshtatshme të kthehen në objekte atraktive hoteliere, galeri, muze dhe të ngjashme. Pasuritë folklorike kulturore dhe etnografike të këtij territori do të mund të shfrytëzohen më shumë për turizëm, si propagandë turistike, po ashtu edhe për bërjen e suvenireve, si dhe për shfaqjen e manifestimeve të ndryshme. Restorante me kapacitete të vendosjes dhe fjetjes në Komunën tonë janë disa, të cilat janë të ndërtuara përgjatë rrugëve. Në Komunën e Deçanit afrojnë 68 biznese turistike dhe atë: 15 hotele dhe motele, 48 restorante dhe të tjera, 5 agjenci udhëtimi. Për nga karakteristikat e veta hapësinore terrenet më potenciale (lokalitet) në “Bjeshkët të Nemuna” janë: “Maja Ropsit”, “Bjeshka e Belegut”, “Kurvallës, Roshkodoli” etj. Për zhvillimin e turizmit rëndësi ka një edhe ndërtimit rrugës Deçan-Kozhnjer-Plavë (Malin e Zi), e cila do të fitonte një funksion të rëndësishëm në zhvillimin turistike ndër-regjionalë.

#### 4.11. Bizneset private

Numri i bizneseve të regjistruara është 807<sup>3</sup>, të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në të gjitha lokalitetet e Komunës së Deçanit dhe atë 330 biznese në qendrën urbane, kurse 477 biznese në lokalitete tjera rurale. Këto biznese edhe pse kanë të punësuar numër të vogël të punëtorëve, prapëseprapë roli i tyre në zvogëlimin e papunësisë është i rëndësishëm. Pikërisht papunësia është problemi kryesor i qytetarëve të Komunës së Deçanit, i cili gjeneron probleme të reja. Në Komunën tonë veprojnë 7 filiale bankare, të cilat kryejnë shërbime të ndryshme për qytetarët. Prej këtyre bizneseve më ndikim në mënyrë indirekte në mjedis operojnë: tri thertore, dy gurëthyes, përpunimi primar të drurit afërisht - 30 shara, pompa të benzinës - 11, ndërsa bizneset e tjera nuk kanë ndonjë ndikim aq të madh në mjedis.

Tabela 2. Struktura e bizneseve private

	<b>Veprimtaria e bizneseve</b>	<b>Nr. i bizneseve</b>	<b>Nr. punëtorëve</b>
1	Tregtare	395	790
2	Prodhuese	140	420
3	Shërbyese	190	380
4	Të tjera	82	164
<b>5</b>	<b>Total</b>	<b>807</b>	<b>1754</b>

3 Këto të dhëna ndryshojnë nga viti në vit

## 5. INFRASTRUKTURA DHE SHËRBIMET PUBLIKE

### 5.1. Ujësjellësi dhe kanalizimi

Rrjeti i ujësjellësit i cili ka filluar të ndërtohet nga vitet '50-ta për të vazhduar me zgjerimin e tij në vitet '80-ta dhe '90-ta dhe përdhën e pasluftës nga viti 2000-2011 ku ka arritur një mbulueshmëri relativisht të madhe. Deri sot është arritur të mbulohen pjesa dërmuese e vendbanimeve me rrjet të ujësjellësit primar i cili arrin një gjatësi prej 189 km. Kjo infrastrukturë për kohën ishte e mjaftueshme, mirëpo shtimi demografik dhe rritja e standardit jetësorë shtruan kërkesa të reja për riparimin, zgjerimin dhe shtimin e rrjetave të reja të ujësjellësit dhe kanalizimit. Që nga viti 1999 e deri në vitin 2010, në komunën e Deçanit janë implementuar rreth 16 projekte të cilat fillimisht kishin për synim rehabilitimin dhe riparimin e rrjeteve – sistemit ekzistuese, të cilat projekte u financuan kryesisht nga NCA-ja Norvegjeze.

Sipas të dhënave rreth 70 % e popullsisë kanë qasje në furnizimin publik me ujë të pijes, ndërsa në rrjetin e kanalizimit kanë qasje 0 %, kanalizimi për ujërat e ndotura është në ndërtim e sipër.

Vetëm në qytetin e Deçanit jetojnë rreth 3794 banorë, prej të cilëve 100 % kanë qasje në rrjetin publik të ujësjellësit. Pjesa tjetër e popullsisë e cila jeton në zonat rurale furnizohen me ujë nga pusët e hapura në mënyrë individuale. Nga 37 fshatra që ka Komuna e Deçanit, 2 fshatra kanë ujësjellës vetanak, 21 fshatra kanë ujësjellës të përbashkët dhe rreth 14 fshatra ende nuk kanë këtë çështje të zgjidhur.

Gjendja ekzistuese vlerësohet të jetë e kënaqshme me tendencë përmirësimi në rritje. Në dekadën e fundit herë pas here është riparuar dhe zgjeruar edhe në zona tjera rurale, duke aplikuar standarde të avancuara të ndërtimit me lloje të materialeve sipas standardeve që sot janë aktuale në vend, regjion dhe botë, gypa PE nga NCA-Norvegjisë, Komuna, CDF. Sistemi i furnizimit është me gravitet (rënie të lirë), ku përveç sistemit të rrjetit kryesor në qytetin e Deçanit kemi edhe sistemin e fshatit Strellc, Isniquit, regjionit të Vokshit, si dhe sistemin e CDF-it që përfshinë pesë fshatra ku dy prej tyre i përkasin Komunës së Pejës (Krysheci dhe Broliqi).

Në rrjetin e kanalizimit për ujërat e ndotura është në fazën e ndërtimit, në të janë përfshirë rreth 7 vendbanime, duke përfshirë qytetin e Deçanit, kurse 30 vendbanime të tjera nuk e kanë të zgjidhur këtë problem. Pjesa më e madhe e rrjetit të kanalizimit përbëhet nga kanalet e kombinuara me rënie të lirë, të cilat marrin rrjedhat e ujërave të bardha dhe të ndotura (zeza). Sipas gjendjes në terren në Komunën e Deçanit dhe vlerësimi i rrezikshmërisë nga ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe atyre nëntokësore pjesa më e rrezikuar e popullsisë është ajo në zonat rurale të cilët furnizohen me ujë të pijshëm nga pusët. Pra ato paraqesin rrezik për qytetarët, të cilët përdorin ujin e pakontrolluar dhe ka dëshmi se shumë prej tyre furnizohen me ujë të ndotur. Menaxhimi i ujërave të ndotura në këtë Komunë aktualisht nuk bëhet nga asnjë kompani, meqenëse nuk ka rrjet të ndërtuar të kanalizimit për ujëra të ndotura.

### 5.2. Menaxhimi i mbeturinave

Menaxhimi i mbeturinave në qytet bëhet nga Kompania “Higjiena dhe Ujësjellësi” e cila e bënë mbledhjen, grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave në deponin regjionale (Sverk të Thatë-Pejë). Kjo kompani, gjithashtu, kontraktonte punë me Komunën për mirëmbajtjen e hapësirave pub-

<sup>1</sup> Njesia në: mg/Nm<sup>3</sup> 6% O<sub>2</sub> i thatë

like (rrugëve, sipërfaqeve të gjelbërua dhe trotuareve). Për kryerjen e shërbimeve për grumbullimin e mbeturinave e njëjta kompani ballafaqohet me mungesë të numrit kontejnerëve 1.1 m<sup>3</sup> dhe atyre familjarë 120 l. Grumbullimi i mbeturinave bëhet vetëm në pjesën urbane andaj kjo kompani në mungesë të numrit të kontejnerëve nuk ka shtrirë rrjetin e vetë edhe në pjesën rurale. Në qytet shërbimin për grumbullimin e mbeturinave nga bizneset dhe ekonomitë familjare kompania e bën sipas kontratave të veçanta. Bartja e mbeturinave bëhet me traktor, pastaj të njëjtat zbrazen në kamion, por edhe me kamion mikser. Zbrazja/pastrimi i kontejnerëve bëhet pesë ditë të javës, por edhe sipas nevojës. Tarifat për mbeturina është 3.50 € për shtëpi, ndërsa për veprimtaritë ekonomike janë të caktuara sipas aktivitetit të tyre.

Në zonat rurale mbledhja/grumbullimi i mbeturinave bëhet nga OJQ “Pastrimi Rural” në 10 fshatra, nga dy herë në javë. Ekonomitë familjare i ka pajisë më kontejnerë 80 l, por edhe më thasë të plastikës. Përgjigjja e qytetarëve për të paguar shërbimet e ofruar është shumë e ultë dhe është një nga problemet që duhet të punohet ma shumë në këtë drejtim, rreth ndërgjegjësimit të qytetarëve. Sa i përket riciklimit të mbeturinave, si: hekurit, aluminit, letrës, plastikës, bëhet nga disa individ privat edhe nga një numër i vogël i bizneseve.

#### 6.4. Infrastruktura rrugore dhe transporti publik

Gjatësia e përgjithshme e rrugëve lokale në Komunën e Deçanit është rreth 172 km dhe 2 ura. Transportin e qytetarëve në Komunën e Deçanit e bëjnë kryesisht transportuesit publikë dhe privatë. Pasqyra e rrjetit rrugor që e përshkon territorin e Komunës së Deçanit është si më poshtë:

Rrugë magjistrale: Pejë - Gjakovë e përshkon territorin e Komunës së Deçanit në gjatësi prej 24 km.  
Rrugë rajonale: Carrabreg - Voksh në gjatësi prej 6 km është e asfaltuar

Tabela 3. Gjendja e rrugëve

Struktura e rrugëve	Km
Rrugë të asfaltuara/km	138.90
Rrugë të paasfaltuara/km	33.40

#### 6.4. Ndriçimi Publik

Në zonën urbane të Komunës ka gjatësi prej 74 metra. Rrjeti i sistemit të ndriçimit është i përbërë prej 110 shtyllave, prej tyre 70 shtylla metalike, ndërsa 40 shtylla të drurit, më se 90 % është ndriçim eficient. Ndriçimi rrugëve është i shtrirë në pjesën rurale në këto fshatra: Strellc i Epërm, Strellc i Ultë, Glllogjan, Isniq, Irzniq, Prejlep etj. Duhet të përmirësohet ndriçimi i rrugëve me ndriçim të mesëm.

#### 6.5. Shërbimet e telekomunikacionit dhe mediat

**Telefonia fikse** - Është e shtrirë, përveç qytetit, edhe në disa fshatra (Carrabreg, Beleg, Lluke e Epërm, Isniq, Strellc, Lëpushe, Prapaqan, Lloqan), centrali është digjital. Ky rrjet menaxhohet nga njësia e Post-Telekomit të Kosovës (PTK-së).

**Telefonia mobile** - Është e mbuluar mjaft mirë, pothuajse të gjitha vendbanimet kanë qasje në shërbimet e telefonisë mobile, të cilat ofrohen nga operatorë të licencuar: Vala, Ipko dhe Kujtesa.

Edhe shërbimet e internetit janë shpërndarë pothuajse në të gjitha vendbanimet e Komunës.

**Radiotelevizioni** - Në Komunë është një radio lokale, ndërsa nuk ka televizion lokal.

## 7. SHËRBIMET SOCIALE

### 7.1. Arsimimi

Sistemi i edukimit-arsimimit në Komunën e Deçanit është i organizuar në tri nivele: arsimimi para-fillor, fillor dhe i mesëm. Në Komunën e Deçanit janë 17 shkolla fillore dhe 4 paralele të ndara, ndërsa shkolla të mesme janë 3.

Struktura organizative e sistemit arsimor është e organizuar në katër nivele: niveli 0, arsimit parashkollor (5-6 vjeçar), niveli i I-rë, arsim fillor (I-V), niveli II-të, arsimit mesëm i ulët (VI-IX) dhe niveli III-të, arsimit i mesëm i lartë (X-XII).

Në vitin 2002 u krijua një model i ri për sistemin arsimor në vend. Struktura e reformuar ofron 5 vjet të arsimit fillorë, pasuar nga 4 vjet të shkollimit të ulët të mesëm dhe 3 apo 4 vjet të shkollimit të lartë të mesëm. Për fëmijët e moshës nën 5 vjeç, brenda territorit të Komunës është vetëm një çerdhe (private).

#### **Numri i nxënësve nëpër nivele dhe paralele është:**

- Numri i nxënësve në nivelin 0 (niveli parashkollor) - 486;
- Numri i nxënësve në nivelin I (niveli fillor kl. I-V) - 2754;
- Numri i nxënësve në nivelin II (niveli i shkollës së mesme të ulët kl. VI-IX) - 2482 dhe;
- Numri i nxënësve në nivelin III (niveli i shkollës së mesme të lartë kl. X-XII/XII) - 2115, ku 1246 janë në gjimnaz, kurse në një shkollë e mesme e lartë profesionale 869.

Disa objekte shkollore kanë nevojë për rregullim të hapësirave rrethuese me gjelbërim, për renovim, ujësjellës, kanalizim, përmirësim të fushave sportive, pajisje me laboratorë, kabinete dhe punëtori me mjete të nevojshme arsimore.

#### **Edukimi mjedisor**

Edukimi mjedisorë sot është një parakusht i domosdoshëm për një zhvillim të qëndrueshëm të mjedisit. Aktivitetet e edukimit kanë për qëllim implementimin e programeve për fushat e ndërgjegjësimit të popullatës, vlerësimin e rrezikut për shëndet, ndërtimin kapaciteteve në institucionet shëndetësore dhe aktivitetet për menaxhimin e rrezikut. REC-u në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, nëpër shkolla ka realizuar projektin e “Paketës së Gjelbër”, sipas këtij projekti është arrit të mbahet nëpër shkolla lënda mjedisore. Ky projekt ka ndikuar në ngritjen dhe forcimin e edukatës mjedisore. Gjithashtu, paraqitet edhe një nevojë për organizimin e klubeve mjedisore, të cilët mund të zhvillojnë aktivitetet edukuese brenda dhe jashtë shkollës. Mungesa e fondeve ka shkakuar vështirësi për zhvillimin e mëtejshëm, e të vazhdueshëm të procesit për ndërgjegjësimit (ngritjen e kulturës mjedisore) të popullsisë.

### 7.2. Shëndetësia

Nga fusha e shëndetësisë funksionojnë disa institucione, prej të cilave qytetarët marrin, mbrojtje primare shëndetësore, të cilët punojnë si njësi (punte) të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare të Deçanit. Pasqyra e institucioneve shëndetësore në kuadër të Komunës është:

Tabela 4. Qendrat shëndetësore në Komunën e Deçanit

Nr.	Emri i institucionit shëndetësor	Vendi	Numri i mjekëve/Motrave	Problem
1	Qendra kryesore e mjekësisë familjare	Deçan	20/77	Mungesë lokacioni për deponimi të mbeturinave (mbetjeve) ambulatorie deri në transportim për insenerator.  Vetëm qendra e mjekësisë familjare në Irzniq ka insenerator, i njëjti nuk funksion për arsye teknike.
2	Qendra e mjekësisë familjare	Srelle i Epërm	1/2	
3	Njësi (punkt)	Prapaqan	1/1	
4	Qendra e mjekësisë familjare	Isniq	2/2	
5	Njësi (punkt)	Prejlep	Nuk punon	
6	Qendra e mjekësisë familjare	Irzniq	2/2	
7	Qendra e mjekësisë familjare	Gramaçel	1/2	
8	Njësi (punkt)	Lumbardhë	Nuk punon	
9	Njësi (punkt)	Ratish i Ultë	1 motër (infermiere)	
10	Qendra e mjekësisë familjare	Voksh	1/2	

Në disa vendbanime veprojnë disa ordianca dhe barnatore private. Gjithashtu, funksion edhe qendra për rehabilitim psikologjik që gjendet në lokacioni e ashtuquajtur “Podin e Gështenjave” - Deçan. Shërbime parësore të fushave të specializuara mjekësore afron, gjithashtu, edhe sektori privat. Vlen të përmendet se koncentrimi i sektorit privat është kryesisht afër Qendrës kryesore të mjekësisë familjare në qytet.

Mirëqenia sociale - Komuna e Deçanit është në mesin e komunave jo mjaft të zhvilluara të Kosovës, prandaj edhe varfëria është e theksuar. Shfrytëzues të asistencës sociale janë 930 familje.

### 7.3. Trashëgimia natyrore

Komuna e Deçanit është e njohur me trashëgimi kulturore dhe natyrore ku një pjesë e kësaj pasurie është e vendosur nën mbrojtje sipas kritereve ndërkombëtare. Deçani disponon “Bjeshkët Nemuna” që janë propozuar për Park Nacional. Ai paraqet një prej vlerave më të rëndësishme natyrore; që i plotëson të gjitha kushtet për Park Nacional. Me shpalljen të tij Park Nacional, Deçani do të përfitonte si në aspektin ekonomik, po ashtu edhe atë turistik dhe rekreativ.

Me monumente kulturore historike, si dhe atyre natyrore, siç janë pjesa e “Bjeshkëve të Nemuna” me natyrën karakteristike të tyre. Bukuritë natyrore dhe vlerat e këtij territori e posaçërisht “Gryka e Deçanit” kanë vend të rëndësishëm në vlerësimet e vlerave të peizazhit dhe bukurive natyrore specifike me florë dhe faunë. Vlerë të mëdha këtij territori i shtonë edhe “Gryka e Deçanit” më “Kanjonin e Lumëbardhit” të Deçanit, si dhe “Gryka e Lloqanit” me “Lumëbardhin e Lloqanit”, vlera që krijojnë mundësi të jashtëzakonshme për ekskursione të ndryshme, vizita nga turistët e huaj, si dhe ata vendas.

**Monumentet natyrore** - Gryka e Deçanit është e formuar nga “Lumëbardhi i Deçanit”, kurse “Gryka e Lloqanit” nga “Lumëbardhi i Lloqanit”. Këto gryka janë me bukuri të rralla natyrore shumë interesante dhe të rëndësishme, jo vetëm për rrafshin e Dukagjinit, por edhe në tërë territorin e Kosovës. “Luginë e Lumëbardhit”, po ashtu, është e ndërtuar në kanjonin e glacialit të dikurshëm në luginën që është e gjatë 30 km. Në të dalje të Grykës, është qendra rekreative-turistike kompleksi i hoteleve dhe pushimorja e fëmijëve, e cila pjesë duhet të jetë bazë për zhvillimin e më-

tutjeshëm të një qendre turistike-rekreative për “Bjeshkët e Nemuna”. Gjithashtu, në këtë pjesë gjendet edhe kompleksi i trungjeve të pishës së zezë pyjore, i vënë në mbrojtje ligjore, si zonë e mbrojtur e pishës pyjore. Ky pyll është mbjellë në pjesën e parë të shek. XIX-të, më sipërfaqe prej 11,79 ha, kurse pjesët jugore dhe lindore të këtij pylli janë të pasur më gështenjë.



Foto 14. Gryka e Deçanit

Trungjet e blirit në fshatin Isniq janë kompleks prej 21 lisave, të cilët janë vënë në mbrojtje ligjore dhe gjenden në Varrezat e Osdautajve, ku prej këtij kompleksi prej 11 lisave janë gjendje të mirë natyrore. Gjithashtu, është i propozuar për mbrojtje është edhe bliri në Rastovic, i vjetër mbi 350 vjet, më gjatësi 25-30 m dhe diametër 1.5 m. Gjendja e tyre është e mirë, mirëpo mungon një pllakë e shënuar se këto trungje janë të mbrojtura, që në të ardhmen duhet të vendosen.

**Rezervatet natyrore si:** - “Kozhnjerit”, “Maja Ropsit”, “Bjeshka e Prejlepit”, “Zona e Rëndësisë së Posaçme” (viti i shpalljes 2005), si dhe pjesë të tjera të “Bjeshkëve të Nemuna”, nga aktivitetet e faktorit njeri nga prerja e pyjeve, vije në shprehje edhe erozioni, i cili në disa hapësira ka bërë shpëlarje të dheut, daljen në sipërfaqe të shkëmbinjve. Prej bimëve drunore ma të rëndësishmet në këto rajone janë: Gështenja (*Castane Sativa*), Hormoçi (*Picea*), Bredhi (*Abis*), Arneni (*Pinus Peuce*), Arneni i bardhë (*Pinus Cheldreichii*), Ahu (*Fagus moesiaca*) dhe llojet e ndryshme të fletorëve. Në Grykën e Deçanit dhe Lloqanit është mjaft mirë e zhvilluar edhe verri (*Alnus*) dhe lloje të ndryshme të shelgut (*salix*). Vlen të theksohet edhe aspekti gjeologjik, që është mjaft heterogjen dhe dallon nga pjesët e tjera të Alpeve Shqiptare (Bjeshkët e Nemuna).

Në të hasen disa lloje të shkëmbinjve, me të përhapurit janë shkëmbinjtë silikat, serpentini dhe karbonit (dollarmitet). Shkëmbinjtë silikat janë të përhapur edhe në “Majën e Ropsit” dhe aty është prezent një florë, gjithashtu karakteristike që dallon nga pjesët e tjera të Alpeve Shqiptare.

Prej llojeve bimor, që janë të rrezikuara nga nxjerrja e rrënjëve për t’u shitur duhet cekë lloji



Foto 15. Gështenja

Gentiana Lutea (gentiana e verdhë-lincuri), e cila më parë kishte një shtrirje të gjerë, kurse tani ka mbetur në disa lokalitete gati në zhdukje. Kjo bime është shëruese (përdoret për plagë dhe sëmundje të lëkurës) dhe rrënjët e saja edhe sot përdoren dhe shiten me çmim të lartë. Përveç shfrytëzimit të egër të bimëve të larta (vaskulare) duhet bërë edhe edukimi i atyre njerëzve që bëjnë grumbullimin e kërpudhave. Duhet të mësohen si duhet bërë vjelja (jo të mirën më rrënje, por të priten me

thike në mënyre që të mos të ndikojnë në zhdukjen e këtyre bimëve që kane rendësi ekonomike). Në aspektin vegetacionit rëndësi kanë disa fitocenoza që janë mjaft të rralla si wulfenis dhe arnenit (molikës).



Foto 16 dhe 17. Kantarioni (*hypericum perforatum*)



Foto 16 dhe 17. Kantarioni (*hypericum perforatum*)

4. Peçi Naqellari: Praktikum i botanikës dhe metodika e përcaktimit të bimëve. Shtëpia Botuese, Toena, Tiranë, 2003, fq. 137.



Numri i zonave të mbrojtura<sup>5</sup> sipas kategorisë, rëndësisë, vendit dhe sipërfaqes, në kuadër të Komunës janë të paraqitura në tabelë.

Tabela 5 . Zonat dhe monumentet e mbrojtura në Deçan

Nr.	Emërtimi i zonës/objektit	Komuna	Sipërfaqja në ha	Viti i mbrojtjes	Kategoria në Kosovë	Kategoria UUCN	Përshkrimi i shkurtyr i vlerave
<b>Rezervat e natyrës</b>							
1	“Maja e Ropsit”.	Deçan	20.00	1955	II	I	Rezervat bimore të llojeve të molikës, bredhit, pishës dhe ahut.
2	“Kozhnjerri”.	Deçan	150	1955	II	I	Rezervat natyror, i llojit dhia e egër (Rupocapra rupicapra L).
3	“Malet e Prelepit”.	Deçan	0.92	1963	II	I	Rezervat bimor me përbërje të pastër të panjës malore (Acer heildreichii).
<b>Monimentet e natyrës</b>							
1	Bliri në Isniq (Tilia argenta)	Deçan		1968			Moniment natyror me karakter botanik.
2	Trungjet e blinit në Isniq.	Deçan		1968			Moniment natyror me karakter botanik.
<b>Park-Pylli</b>							
1	Pishat e Deçanit.	Deçan	15	1968		V	Përbërje e pastër e pishës së zezë.

5 Të shpallura sipas ish-Krahinës Autonome Socialiste të Kosovës (Institutit për Mbrojtje të Natyrës).

Tabela 6. Objektet e propozuara për mbrojtje

Nr.	Emërtimi i zonës/objektit	Komuna	Sipërfaqja në ha	Viti i mbrojtjes	Kategoria në Kosovë	Kategoria UUCN	Përshkrimi i shkurtër i vlerave
<b>Rezervat e natyrës</b>							
1	“Bjeshka e Strelcit”.	Deçan		2002	II	I	Rezervat botanike të llojit Pinus hedreichii.
2	Regjioni i Deçanit.	Deçan		2002			Rezervat botanike - Gështenja (Castane sativa).
3	Regjioni i Vokshit.	Deçan		2002			Rezervat botanike.
4	“Bjeshka e Roshkodolit”.	Deçan		2002			Rezervat botanik (Pinus poece) - molika.
5	Dervishkomi.	Deçan		2002			Rezervat botanike.
<b>Monumentet e natyrës</b>							
1	Pisha - Llukë e Ultë.	Deçan		2002			Monument natyror.
2	Bliri - Rastovic.	Deçan		2002			Monument natyror.
3	Bliri - Irzniq.	Deçan		2002			Monument natyror.
4	Bliri të Varrezat e Iberhysajve - Deçan.	Deçan		2002			Monument natyror.
5	Bliri në Pobergjë.	Deçan		2002			Monument natyror.
<b>Peizazhe</b>							
1	“Burimi i Lumëbardhit” -B. Roshkodolit.						Kanion me ujëvarë me rendësi edukativo – arsimore.
2	“Gryka e Deçanit” dhe “Gryka e Lloqanit”.						Kanion me rendësi edukativo - arsimore

#### 7.4. Trashëgimia kulturore

Territori i Deçanit është i pasur me monumente kulturore, historike dhe arkeologjike. Vendet më interes të madhe janë, lokalitetet arkeologjike parahistorike në Vranoc të Vogël, Glllogjan, Strelc i Epërm, Rastovicë, Irzniq, dhe Baballoq, monumentet myslimane, kullat, monumentet kristiane, si dhe mullinjtë. Identifikimi i vendeve me rëndësi arkeologjike janë në: Llukë e Epërm, Lëbushë, Kisha Selishtave, Rrazhga, Qelia, Shpella e madhe, Balleja Kozhnjerri, Carrabregu etj. Më interes të madh në Komunën tonë kemi një numër të madhe të kullave, të kompleksit të kullave në disa fshatra të Komunës së Deçanit, siç janë kompleksi i kullave në Isniq dhe Dranoc, si dhe një numër i kullave në fshatrat e Deçanit. Ndër kullat më të njohura janë kulla e Osdautajve dhe ajo e Kuklecëve në kompleksin kullave në Isniq, kulla e Demukajve dhe Mushkolajve në Deçan, Kulla e Mazrekajve dhe Binakajve në kompleksin e Kullave në Dranoc, Kulla e Ramë Shabanit në Prapaqan, Kulla e Ali (Demë) Gecit në Llukë të Ulët<sup>6</sup>, Kompleksi i Qelisë, si dhe një numër i kullave në pjesët e tjera të Komunës tonë.

Kulla është një shtëpi e fortifikuar prej gurit që zanafillën e ka që nga kohërat e lashta, që ka evoluar në formën e sotme, e që destinimin primar i tyre ka qenë mbrojtja nga pushtuesit e ndryshëm të kohës. Kullat janë objekte të ndërtuara më gurë të gdhendur më porta dhe dritare në formë harku që zakonisht kanë qenë me tri dhe katër etazhe (kate). Kati i parë (etazhi i parë) ka shërbyer për ruajtjen e bagëtisë, kati i dytë (etazhe i dytë) është i destinuar për banim dhe përbëhet nga korridori i brendshëm dhe dhomat për fjetje, kurse kati më i lartë është i zbukuruar më punime artizanale nga druri, oda e burrave, është punuar më dekorime të ndryshme nga druri (tavani), punime dore, si dhe punime të tjera artizanale, kurse në pjesën ballore të saj gjendet oxhaku karakteristik dhe është destinuar për pritjen e mysafirëve.

<sup>6</sup> [histori/sh\\_i\\_tahir\\_geci.htm](http://histori/sh_i_tahir_geci.htm) dt.22/05/2012



Foto 20. Kulla e Osdautajve



Foto 21. Kulla e Ali (Demë) Geci



Foto 22. Manastiri i Deçanit

Objekte të tjera kulturore historike janë edhe xhamitë e vjetra në Komunën tonë të ndërtuara me një arkitekturë të veçantë autoktone shqiptare, siç janë: Xhamia në Deçan, në Carrabregin e Epërm, në Dranoc dhe ajo në Isniq. Përpos këtyre monumenteve, kemi edhe mullinjët në fshatin Isniq dhe Deçani të ndërtuar në arkitekturë autoktone dhe që punojnë dhe vizitohen deri në ditët e sotme. Si monumente të tjera duhet cekim Manastirin e Deçanit, objekt me një arkitekturë të veçantë dhe kompleks në pjesën e hyrjes në Grykën e Deçanit dhe shumë atraktive për vizitorë.

Sipas gojëdhënave, përreth kishës së sotme, gjendeshin dy-tri fshatra që shtriheshin rrëzë maleve e deri të Kershës i Mark Gegës (mikrotoponim), këto vendbanime 2-3 km, sipër manastirit gjenden të ndërtuara afërsisht dyqind deri treqind vjet para kishës së sotme - "Kulla e Qelisë"<sup>7</sup>. Lokaliteti "Kulla e Qelisë", shtrihet në pjesën shkëmbore, rrëzë maleve të Isniqit, respektivisht mbi Manastirin e Deçanit. Përbrenda lokalitetit "Kulla e Qelisë" ekzistojnë edhe gjurmët e një objekti sakral, i cili po ashtu i ka rezistuar kohës. Në këtë lokalitet janë gjendur gjurmë të disa afreskeve. Po ashtu, në afërsi të "Kullës së Qelisë", sot gjenden gjurmët e ruajtura shumë mirë të një godine e cila është e ndërtuar prej gurëve të vegjël e të gdhendur dhe të ruajtur mirë. Kjo godinë është e mbuluar me qemerë të gurit të cilat janë të ruajtura mirë.

Edhe dyshemeje e kësaj godine është e shtruar me gurë të gdhendur. Në këtë lokalitet arkeologjik janë gjeture edhe fragmente shumë të rëndësishme për kohën, përmes të cilave mundet të bëhet edhe datimi i këtij lokaliteti të lashtë me vlera historike. Monumentet kulturore-historike dhe arkeologjike paraqesin për Komunën tonë një pasuri, të cilën duhet në të ardhmen të mbrohen dhe shfrytëzohen për zhvillimin e turizmit.

## 8. GJENDJA E MJEDISIT

### 8.1. Ajri

Ndotësit e ajrit janë kimikatet, grimcat e pluhurit ose materiet biologjike që shkaktojnë dëmtime ose shqetësime tek njerëzit dhe organizmat e tjerë apo shkaktojnë dëme në mjedisin natyror në atmosferë. Efektet shëndetësore shkaktohen nga ndotësit e ajrit klasifikohen si të ndryshme fiziologjike dhe biokimike të lehta deri në vështirësi në frymëmarrje (raspiatore) dhe probleme të ndryshme kardiale. Burimet e ndotjes së ajrit mund të jenë natyrore ose antropogjenë. Ndotësit kryesor të cilët ndikojnë në cilësinë e ajrit si NO<sub>x</sub>, SO<sub>2</sub> dhe benzeni emitohen nga djegia e lëndës fosile për energji dhe transport. Njëri ndër problemet kryesorë që paraqitet si pasojë e ndotjes nga transporti është emisioni i lartë i gazrave nga lëndët djegëse të automjeteve si: CO<sub>2</sub>, NO<sub>x</sub>, SO<sub>2</sub>, CO. Emisionet nga automjetet shkaktojnë pjesën më të madhe të ndotjes me metalet e rënda si: Pb etj. Koncentrimi më i madh i kësaj ndotjeje nga qarkullimi i automjeteve është përgjatë rrugës kryesore Pejë-Deçan-Gjakovë. Në ndotje të ajrit ndikon edhe djegia mbeturinave dhe deponitë ilegale. Dendësia e trafikut, mungesa e hapësirave për parkim, makinat e vjetruara, mungesa e hapësirave të gjelbëruara apo mirëmbajtja jo e mirë e tyre janë burim i ndotjes së madhe të ajrit. Sektori i industrisë nuk punon që nga pas lufta.

#### IDENTIFIKIMI I PROBLEMEVE:

- Vendosja e sistemit për monitorimin e ajrit;
- Ndotja e ajrit që shkaktohet nga djegia e mbeturinave nga qytetarët e pandërgjegjshëm;

<sup>7</sup> Shkodran Imeraj: [www.filolet.com/sh\\_imeraj\\_kulla.htm](http://www.filolet.com/sh_imeraj_kulla.htm), dt.02/05/2012

- Mungesa e transitit për mjetet e rënda transportuese;
- Mungesë e trajtimit të ujërave të zeza;
- Prerja dhe degradimi i pyjeve;
- Automjetet e vjetërsuara dhe;
- Mungesa e energjisë elektrike (tensioni i ulët në disa pjesë të vendbanimeve)

## 8.2. Zhurma

Zhurma është njëra nga brengat e vazhdueshme për këtë zonë. Komuna nuk ka pajisje për matjen zhurmës. Burimi kryesor i zhurmës vjen nga komunikacioni dhe ka efekt negativ. Në planin zhvillimor të Komunës janë planifikuar zonat e mbrojtura nga zhurma. Në këto zona nuk do të lejohet ndërtimi dhe lejimi i aktiviteteve të subjekteve afariste, që shkaktojnë zhurmë mbi nivelet e lejuara me ligj. Këtë e vërteton edhe hulumtimi në terren, ku ndotja nga zhurma është theksuar si ndotësi më i madh, me 50 %. Në rrugët kryesore dhe rrugëve lokale duhet të bëhet mbjellja e drurëve përgjatë shiritave të gjelbërimit me qëllim të amortizimit të zhurmës.

### REKOMANDIME:

- Identifikimi i zonave ekzistuese të zhurmës;
- Zvogëlimi i zhurmës në zonat urbane;
- Zvogëlimi i zhurmës nga automjetet dhe gjeneratorët;
- Zhvillimi i sistemeve për monitorimin, hartimin e hartave për zonat e zhurmës dhe;
- Zhvillimi i normave efikase dhe ekologjiksht normale.

## 8.3. MENAXHIMI I UJIT

### 8.3.1. Furnizimi më ujë të pijshëm

Ndërmarrja e ujësjellësit menaxhon me rrjetin e ujësjellësit që ofron shërbime për qytetin e Deçanit dhe 25 fshatrave, me numër të konsumatorëve prej 5.360, koha e shërbimit - ofrimit të ujit të pijshëm është 24 orë, pa ndërprerje, me përjashtim të rasteve kur ka defekte apo probleme të tjera (prishje për arsye të ndryshme). Burimet e marrjes së ujit janë burimet natyrore të cilat janë të kaptuara, kurse për nga cilësia e ujit cilësohen jashtëzakonisht të pastra. Uji i ofruar për zonën e shërbimit, të cilën e mbulon kjo ndërmarrje i plotëson standardet e ujit të pijshëm, sipas analizave kimike dhe bakteriologjike që bëhen nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë së Kosovës dhe standardeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH), si dhe rregulloreve dhe normave të IKSH. Metoda e pastrimit/përpunimit të ujit është vetëm me sistemin e klorifikimit në stacionet e klorinimit.

## 8.5. Rrjeti i ujësjellësit

Gjatësia e përgjithshme e rrjetit të sistemit për furnizimi me ujë të pijshëm është 189 km. Materiali i ndërtimit: pjesa dërmuese është nga materiali polietilen, kurse pjesa tjetër PVC dhe asbest-tipi C dhe B të cilët medoemos duhet të ndërrohen. Numri i rezervuarve 8 prej tyre 5 janë të ndërtuara nga betoni, kurse 3 nga llamarina. Burimet ekzistuese të furnizimit-burim natyror.

## 8.6. Rrjeti i kanalizimit atmosferik - gjendja ekzistuese

Infrastruktura e rrjetit të kanalizimit atmosferik është i shtrirë vetëm në qytetin e Deçanit, i cili është projektuar dhe ndërtuar gjatë vitit 2007-2008, i cila ka përfshirë fillimisht pjesën urbane të qytetit. Materiali i ndërtimit është i llojit PVC  $\varphi=200-1000$ . Ky rrjet i kanalizimit mbulon vetëm qytetin, ndërsa në fshatra ku rrjeti rrugorë është i asfaltuar nuk është i instaluar.

## 8.7. Trajtimi i ujërave të ndotura - gjendja ekzistuese

Trajtimi i ujërave të ndotura është çështja më problematike në Komunën e Deçanit, deri me tani nuk ka qenë e mbuluar me rrjet përkatës. Siç u potencua më lartë, këtë vit është mbuluar një pjesë e vendbanimeve me këtë rrjet, por jashtë rrjetit kanë mbetur edhe 31 fshatra. Në disa prej tyre kanë ndërtuar rrjetet e veta lokale, por pjesa dërmuese përdorë sistemin e gropave septike.

Kanalizimi për ujërat e ndotura, i cili është në ndërtim e sipër dhe në të janë lidhur krahas qytetit të Deçanit edhe këto fshatra: Beleg, Cararbreg i Epërm, Carrabreg i Ultë, Llukë e Epërm, Llukë e Ultë dhe Lumbardhë. Disa nga fshatrat kanë të ndërtuar me mjete vetanake kanalizimin për ujëra të ndotura, Strellci Ultë-Lagja Jusaj, Isniq-Lagja Tishukaj, Rastovicë, Gramaqel, Dranoc dhe Hulaj. Pjesa tjetër e popullsisë, afërsisht 60 %, nuk kanë të zgjidhur problemin e ujërave të ndotura. Këto ujëra derdhen në sipërfaqe të hapur në lumenj, përroje dhe kanale të ujitjes. Disa nga familjet kanë të ndërtuar edhe gropat septike, të cilat nuk janë të ndërtuar sipas kriterëve të ndërtimit dhe ato ma shumë janë gropa grumbulluese. Mirëpo, vlerësohet se ato fshatrat që furnizohen me ujë të pijes nga pusët (bunarët), kanë ujë të cilësisë jo të mirë, e derdhja e ujërave të ndotura në sipërfaqe të hapur, po ashtu, ato ndikojnë në ndotjen edhe të ujërave nëntokësore.

## 8.8. Ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore

Deçani me rrethinë është i pasur me rrjedhat e ujërave sipërfaqësore dhe atyre nëntokësore. Të gjithë lumenjtë dhe përroskat në territorin e Komunës së Deçanit rrjedhin në drejtim të “Drinit të Bardhë”. Këta lumenjtë burim të furnizimit me ujë i kanë nga burimet të shumta dhe reshjet atmosferike. Këto ujëra gjatë gjithë rrjedhjes së tyre kalojnë nëpër një konfiguracion të thyeshëm të terrenit. “Lumëbardhi i Deçanit” me gjatësi 40,5 km me sipërfaqe të pellgut të saj 243 km<sup>2</sup>. Nën erozion gjenden rreth 53 % e sipërfaqes së pellgut, kurse prodhimi vjetor i aluvionit është 220.700 m<sup>3</sup> ose 900 m<sup>3</sup> /km. Shkëmbinjtë anësor, që ngritën vertikalisht mbi shtratin e tij, ka shumë burime të forta, ujërat e të cilave përdoren për ujitje. Këto burime furnizohen nga shtresat nëntokësore rano-re që marrin atë sasi të ujit që humbet nga lumi ose prej reshurave. Shtresat e borës janë burim kryesor i ujit në këto anë.

Lumenjtë e Komunës së Deçanit rrjedhin nga lartësia e bjeshkëve, janë të rrëmbyeshëm dhe kalojnë nëpër grykat e ngushta, të thella me brigje të rrëpishme që shpesh kanë formën e kantonëve, si “Gryka e Deçanit” dhe “Gryka e Lloqanit”. Ky konfiguracion i terrenit, që ofron kushte të volitshme për ndërtimin e hidrocentraleve. Kozhnjeri, degë e djathtë e “Lumëbardhit”, është ndërtuar Hidrocentrali në Kozhnjer “Lumëbardhi” me kapacitet për prodhim të rrymës elektrike afërsisht 8.4 MG/h. Është paraparë ndërtimi tri hidrocentraleve të ri përgjatë “Lumëbardhit të Deçanit” me kapacitet të prodhimit të rrymës afërsisht 23 MG/h. “Lumëbardhi i Deçanit” është lumë shumë i rëndësishëm për nga ujëshmëria për “Drinin e Bardhë”, karakterizohet më natyrë të pasur me lloje të shumta të florës dhe faunës, që janë karakteristike për “Grykën e Deçanit”. Kjo pjesë karakteri-

zohej më pamje të shumta natyrore me shkëmbinjtë të mëdhenj që ofron kushte për zhvillimin e turizmit. Gjithashtu, ofron mundësi të shumta për hulumtimin e terrenit, gjithashtu me numër të shpellave të pa hulumtuara deri më tani, vende me vlera të trashëgimisë natyrore dhe kulturore që shprehin autoktoninë e deçanasve. Përgjatë rrjedhës së “Lumëbardhit” mund të zhvillohen aktivitetet të shumta rekreative dhe turistike, gjithashtu mund të ndërtohen objekte hoteliere, duke ju përmbytur kriterëve ndërtimore për ruajtjen e mjedisit.

Shtrati i “Lumëbardhit” duhet të rregullohet dhe të ndërtohet shëtitëtorja përgjatë brigjeve të tij, duhet të përgatiten/hartohen projekte nga Komuna. Gjatë tërë vitit “Lumëbardhi i Deçanit” dhe “Lumëbardhi Lloqanit” kanë sasi të mjaftueshme të ujit, përveç periudhën e verës sasia e ujërave në pjesën e poshtme të rrjedhës së këtyre lumenjve zvogëlohet në mënyrë drastike. Problemë është hedhja e mbeturinave degradimi nga shfrytëzimi i shtratit të lumit për rërë dhe zhavorr. Duhet të hartohen strategji që të pengohet/ndalohet eksploatimi i inerteve, hedhja e mbeturinave komunale (amvisërisë), dëmtimi i brezit mbrojtës, si dhe ndërtimi kanaleve primare, sekondare, terciare etj.

#### **Në mënyrë që të zgjidhet problemi i furnizimit me ujë rekomandohen:**

- Përmirësimi i sistemit ekzistues të furnizimit me ujë;
- Ndalimi i keqpërdorimeve dhe detyrimi për përdorimin racional të ujit të pijshëm;
- Kontrolli i cilësisë së ujit të pijshëm edhe nga pusët private;
- Hulumtimi i mundësive për burime të reja ujore;
- Kërkime për burime të ujit në fshatrat tjera ku nuk ka mundësi të mbulohen nga sistemi tanishëm i ujësjellësit dhe;
- Ndërtimi i rrjetit të furnizimit me ujë të pijshëm në dhjetë (10) fshatra (është në ndërtim e sipër nga Komuna dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor).

## **9. MENAXHIMI I MBETURINAVE**

### **9.1 Mbeturinat urbane**

Në disa pjesë të qytetit dhe vendbanime rurale, të cilat nuk janë të mbuluara me shërbimin e organizuar të grumbullimit dhe të transportit të mbeturinave deri në deponin rajonale, mbeturinat hedhen në hapësira publike, (hapësirave të pashfrytëzuara), përgjatë brigjeve të lumenjve, rrugëve lokale dhe rajonale, si pasojë e këtij veprimi vjen deri të krijimi i deponive ilegale me efekte negative për mjedisin. Gjithashtu, në vendbanimet rurale të Komunës ekzistojnë shumë deponi të egra, shpesh herë nga 2-3 sosh në çdo vendbanim. Duke shkaktuar degradim të pjesëve të gjelbëruara, me pasojë të shumta për shëndetin e qytetarëve, duke sjellë pengesa në lëvizje të lirë të tyre, po ashtu edhe automjeteve. Nga hedhja e mbeturinave janë të dëmtuar sipërfaqe bujqësore afërsisht 10.20 ha. Nga 78 deponitë ilegale të identifikuara janë mbyllur 16 prej tyre. Aksioni për mbylljen e deponimeve ilegale nuk është realizuar plotësisht, për arsye të mjeteve financiare. Qyteti ynë disponon një lokacion për tregun e gjelbër, i cili nuk i plotëson as kushtet minimale, gjithashtu disponojmë edhe më një lokacion për tregun e kafshëve, i cili është në periferi të qytetit, që mirëmbahet dhe menaxhohet nga pronari i pronës që ka lëshuar për treg të kafshëve. Në bashkëpunim me komunën dhe USAID-in është realizuar projekti për furnizim me kontejnerë 2500 ekonomi familjare, është realizuar faza e parë e projektit për pajisje me kontejnerë ekonomitë familjare në Deçan, Carrabregu i Epërm, Carrabregu i Ultë, Llukë të Epërm, Llukë e Ultë dhe Prejlep.

## 9.2 Mbeturinat speciale

Në Komunë tonë problem i theksuar janë mbeturinat medicinale, medikamenteve të skaduara dhe eshtrat e kafshëve. Në gjitha qendrat e mjekësisë familjare nuk kanë incenerator, ndërsa në disa qendra të mjekësisë familjare mungojnë mjete për selektim mbeturinave të përgjithshme nga ato medicinale. Po ashtu, mungon sistemi i organizuar i mbledhjes së vajrave të përdorura, baterive dhe akumulatorëve, gomave të automjeteve, automjete e papërdorshme, mbeturinave bujqësore (bimore dhe shtazore), thertoret (eshtrat e kafshëve, gjaku etj.).

### REKOMANDIME:

- Kompletimi i normave ligjore për menaxhimin e mbeturinave bazuar në direktivat BE-së;
- Implementimi i infrastrukturës për menaxhim të mbeturinave;
- Zvogëlimi gradual i sasisë së mbeturinave në burim para deponimit, më anë të riciklimit apo selektimit të tyre dhe;
- Hartimi i projektit për ndërtimin e objektit për djegien e mbeturinave medicinale -ash-tuquajtur “Insinator”, apo asgjësimi i mbetjeve mjekësore më sterilizatorë më metodën e sterilizimit.

## 9.3 Gjelbërimi

Kompania “Higjena” me kontratë bënë mirëmbajtjen e parkut të qytetit (ujitjen, kositjen e barit, si dhe prashitjen e luleve). Gjithashtu, bënë mirëmbajtjen hapësirës publike me sipërfaqe prej 30.000 m<sup>2</sup>. Ajo bënë edhe fshirjen e këtyre rrugëve: “Luan Haradinaj”, Sheshi “Mentor Tolaj”, “Dëshmorët e Kombit”, dhe “Sali Çeku”, që bëhet çdo ditë, me përjashtimisht të ditëve të pushimit. Në kontratë duhet të përfshihet edhe larja e rrugëve, ujitja e hapësirave të gjelbëruara në Sheshin “Mentor Tolaj” dhe në afërsi të lapidarëve. Këto hapësira gjatë verës duhet të ujiten dhe të mbikëqyren në mënyrë më të shpeshtë nga kompania kontraktuese.

Shëtitorja që gjendet në rrugën “Skënderbeu”, gjatë mbrëmjeve verore, është mjaft mirë e frekuentuar nga qytetarët. Të bëhet shtimi i shiritave gjelbëruese përgjatë rrugëve në qytet dhe rreth ndërtesave kolektive.

Tabela 7. Destinimi i sipërfaqeve në Komunën e Deçanit në 524.2 ha është:

Nr.	Destinimi	Sipërfaqja në ha
1	Banuese	259
2	Komerciale	15.40
3	Rrugët	172.30
4	Shkollat	20.0
5	Rekreative	10
6	Industriale	35
7	E degraduar	5
8	Të ndryshme	5
9	E gjelbër	2.5



Vërejtje: Sipërfaqja prej 524.2 ha, janë në kuadër të sipërfaqes së përgjithshme të Komunës

#### REKOMANDIME:

- Hartimi i projektit për gjelbërim (mbjellja të drunjtëve dekorative dhe luleve të ndryshme), përgjatë rrugëve “Luan Haradinaj” dhe “Dëshmorët e Kombit
- Gjelbrimi i sipërfaqeve para ndërtesave, oazat në qendër të qytetit, pjesët anësore të rrugëve me drunjtë dekorative, lule të ndryshme, si dhe mirëmbajtja e tyre;
- Hartimi i projektit për rregullimin e shtratit të “Lumëbardhit” të Deçanit;
- Ndertimi i Hapësirës për lojëra për fëmijë

## 10. Planifikimi hapësinor komunal

Plani Hapësinor, si dokument kryesor i planifikimit në nivelin qendror, ka përcaktuar strategjinë e zhvillimit hapësinor deri në vitin 2015. Struktura hapësinore e territorit të Kosovës shkoqitet në zona, të cilat zhvillimin e vet bazojnë në veçanti të përbashkëta gjeografike, ekonomike dhe sociale. Ndër zonat e propozuara që përfshijnë Komunën tonë janë: Urat e Kosovës (hapësira e verdhë) - Veprimtari shërbyese tregtare, agro-industriale, industri e lehtë dhe turizëm. Deçani, si qytet më pozitiv e vet mjaft karakteristike, me Planifikimin Zhvillimor Urban dhe Komunal ka identifikuar hapësirat, resurset vlerat natyrore dhe kulturore që i ka sistemuar për të krijuar një avantazh në progresin jetësor të kësaj hapësire. Metodologjia e aplikuar në hartimin Planin Zhvillimor Komunal dhe Urban bazohet në normat ligjore të Kosovës, përvojat aplikative të zhvilluara në Kosovë, nga asociacionet e pranuar ndërkombëtarisht, si dhe projektet e dokumenteve të tjera të organizuara dhe zhvilluara në shkallë të vendit apo atë komunale

#### RESURSET NATYRORE DHE BIODIVERSITETI

Pozita gjeografike, faktori gjeologjik, pedologjik, hidrologjik, relievi dhe klima kanë ndikuar që ky territor të ketë një diveritet të pasur biologjik më bimë barishtore shumëvjeçare (hemikriptofita), rreth 70 % dhe bimë drunore dhe shkurret fanerofita rreth 7 %. Biodiversiteti përfshinë shumëllojshmërinë brenda dhe midis llojeve, si dhe shumëllojshmërinë ekosistemeve. Sipas hulumtimeve të bëra janë përshkruar 795 lloje të bimëve të ndryshme, endemike subendemike, që u përkasin elementeve endemike të ndryshme, gjithashtu edhe një numër i madh i llojeve relikte. Po ashtu, ky rajon është i pasur edhe me lloje të shumta të bimëve mjekuese (boronica, linsuri, kamomili dhe çajrave të tjera natyrore etj.). Këto rrethana kanë krijuar kushte të favorshme për ekzistencën dhe ruajtjen e një numri të konsiderueshëm të tyre. Në këtë drejtim ka ndikuar edhe faktori njeri me veprimet e veta me dashje apo pa dashje, duke shkatërruar sipërfaqe të mëdha të fitocenzave pyjore përmes prerjes pa kriter, kullosave dhe djegieve aksidentale apo të qëllimshme. Shpyllëzimet masive, prerjet e pyjeve, zjarret, gjuetia e pakontrolluar, janë disa faktorë që rrezikojnë biodiversitetin. Nga të gjitha këto vjen deri të humbja e sipërfaqeve pyjore, zvogëlimi i fondit të faunës, që ka përfshirë ekosistemin natyrorë është ndër problemet më kryesore për ruajtjen e mjedisit–natyrës në Komunën tonë. Reduktimi sipërfaqeve pyjore dhe degradimi i tyre është si pasojë e shfrytëzimit pa kriter i resurseve natyrore në Komunën tonë. Si pasojë e këtyre veprimeve, vije deri të zvogëlimi dhe zhdukja e shumë llojeve të veçanta bimore dhe shtazore. Fauna e “Bjeshkëve të Deçanit” është e shumëllojshme më shumë lloje që janë karakteristike të kësaj zone, siç janë: rrëqebulli, ariu i murrme (urgus actros), dhia egër (rupicapra rupicapra), ketri (scirflus vulgaris), derri i egër (sus strofa), ujku (canis lupus), macja e egër (fellis silverscis), kaprolli (caprelous), lepuri (lepus europaeus), etj., si dhe lloje

të shpezëve si: shqiponja e maleve, pulegra e madhe etj.

Për këto lloje të faunës shqetësuese është gjuetia e ushtruar gjatë periudhës së riprodhimit, ndërsa për llojet bimore grumbullimi i tyre gjatë fazës së lulëzimit, si dhe mbledhja e rizomave, zhardhokëve dhe organeve të tjera riproduktive të këtyre bimëve. Për tejkalimin e kësaj gjendje nevojitet hartimi i strategjive të ndryshme për ruajtjen e biodiversitetit, implementimi i ligjeve ekzistuese në teren, duke përfshirë edhe fushatat për ndërgjegjësimin e banorëve për ruajtjen dhe mbrojtjen e natyrës. Masivi i bjeshkëve që i takojnë këtij rajoni ofrojnë kushte të favorshme për zhvillimin e turizmit gjatë sezonit dimëror dhe veror, gjuetisë dhe peshkimit. Zhvillimi i gjuetisë dhe peshkimit mund të bëhet pikërisht në ato zona ku fondi i faunës është i pasur më llojet shumta të kafshëve të egra.

Rajonet më potenciale që ofrojnë për zhvillimin e gjuetisë janë: “Kozhnjerri”, “Bjeshka e Baballoqit”, “Bjeshka e Strelcit”, “Bjeshka e Prejlepit”, “Maja e Ropsit”, ndërsa peshkimi mund të zhvillohet përgjatë shtratit të “Lumëbardhit të Deçanit” dhe “Lumëbardhit të Lloqanit”. Si rrjedhojë e ndotjes së madhe të ujërave të lumenjve fauna dhe flora e tyre është e rrezikuar mjaftë.



Foto 24 dhe 25. Bjeshkët e Deçanit



Masivi i bjeshkëve të “Komunës së Deçanit” paraqet një resurs më të pasur më florë dhe faunë që ka rëndësi të madhe për zhvillimin e gjitha formave të turizmit.

## Pjesa 3

### III. IDENTIFIKIMI I PROBLEMEVE

#### Ujërat

<b>Problemi</b>	<b>Shkaku</b> <b>(Listë shkaqesh që sjellin problemin, që mund të jenë, fizike dhe njerëzore.)</b>	<b>Shkalla e ndikimit</b>	<b>Ndikimi</b> <b>(Paraqet ndikim negativ në mjedis, shëndet, mirëqenie etj.)</b>	<b>Prioriteti</b> <b>(I matur me shkallën: *Pak i rëndësishëm **Mesatarisht i rëndësishëm ***Shumë i rëndësishëm.)</b>
Lumenjtë  Ndotja e vazhdueshme nga derdhjet e ujërave të zeza dhe mbeturinat dhe;  Vërshimet si pasojë ngushtimet të shtratit të lumit dhe hedhjes së mbeturinave.	-Derdhja e ujërave të zeza të pa trajtuara; -Hedhja e mbeturinave të ngurta; -Devijimi i shtratit të lumit dhe; -Kanale të ujitjes primitive.	E lartë	-Rritja e nivelit të ndotjes në lumenj; -Zvogëlimi i elementeve kimik të domosdoshëm për zhvillimin e florës dhe faunës në ujë (prishja e biodiversitetit për zhvillimin e mirëfilltë të florës dhe faunës); -Përmbytja e tokave bujqësore nga ngushtimi i shtretërve të lumenjve dhe kanaleve të ujitjes, dhe; -Ujë i papastër.	***
“Lumëbardhi i Deçanit” Degradimi i rrjedhës së lumit dhe ulja e nivelit të ujit, dhe; Derdhja e ujerave të zeza të pa trajtuara.	-Hedhja e mbetjeve urbane në lum dhe në kanale të ujitjes, dhe; -Eksplotimi i rërës dhe i zhavorrit.	E lartë	-Vërshime të tokave bujqësore në stinët e shirave sezonale; -Dëmtim i kulturave bujqësore; -Ndikim në cilësinë e jetës dhe; -Ndotja e lartë e ambientit.	***
Sistemi i ujitjes dhe; Dëmtimi i kanaleve të ujitjes.	-Mos funksionimi i mirëfilltë i sistemit të ujitjes.	E lartë	-Zvogëlimi i sipërfaqeve të ujitura dhe; -Humbja e ujit për ujitje.	***
Rrjeti i kanaleve të ujitjes; Mosmirëmbajtja e kanaleve të ujitjes dhe; Sistemi i vjetruar i kanaleve.	-Humbje e ujit; -Mungesë investimesh dhe; -Mungesa e pendëve për kanale të ujitjes.	E lartë	-Ulja e rendimenteve në bujqësi; -Rënie e cilësisë së prodhimeve bujqësore dhe; -Zvogëlim i të ardhurave.	***
Ujërat nëntokësore dhe;  Ndotja e ujerave nëntokësore nga ujërat e zeza.	-Mungesa e kanalizimit për ujerat e ndotura; -Mbeturinat organike dhe; -Gropat grumbulluese, stallat e kafshëve.	E lartë	-Zvogëlim i sasisë së rezervave të ujërave nëntokësore dhe; -Ndikim negativ në ambient.	***
Burimet e ujërave dhe; Mosmirëmbajtja e hapësirave përreth burimeve.	-Mungesa e infrastrukturës.	E mesme	-Ambient i papastër dhe; -Ndikim në cilësinë e jetës.	**
Burimet e ujërave termo-minerale (uji mineral) dhe; Mungesë e investimeve.	-Promovimi i dobët dhe; -Mungesa e iniciativave për investime.	E mesme	-Shfrytëzim i pamjaftueshëm i potencialeve; -Ambient i papastër dhe; -Ulja e numrit të turistëve.	**

Toka (Dheu)

Problemi	Shkaku	Shkalla e ndikimit	Ndikimi	Prioriteti
Zvogëlimi i sipërfaqes së tokës bujqësore.	-Lëvizje demografike e pakontrolluar dhe' -Ndërtimet në toka bujqësore.	E lartë	-Ndërrimi destinacionit të tokës bujqësore, në ndërtimore pa asnjë kriter; -Ulja e nivelit të zhvillimit të bujqësisë dhe; -Ulja e rendimenteve të prodhimit.	***
Përmbytjet e tokës bujqësore.	-Mospastrimi i shtretërve të lumenjve dhe; -Mos mirëmbajtja e kanaleve të ujitjes dhe kanaleve kulluese.	E lartë	-Humbja e sipërfaqes së tokës punuese dhe; -Ndryshimi i përdorimit të tokës.	***
Ulja e nivelit të punësimit në bujqësi.	-Emigracioni fshat-qytet; -Mungesë subvencionesh dhe; -Mungesë e tregut të shitjes.	E mesme	-Të ardhura të ulëta dhe; -Zvogëlon cilësinë e tokës dhe ndikon negativisht në zhvillimin e qëndrueshëm.	**
Tokat pyjore  Problemi i pakësimit të sipërfaqeve të gjelbëruara.	-Prerja pa kriter i pyjeve dhe; -Kullosja e tepërt.	E lartë	-Ndikimi në peizazhe; -Ndikim në cilësinë e tokës humusore dhe; -Ndikim në cilësinë e ajrit.	***
Degradimi i sipërfaqeve të gjelbëruara në hapësirat publike.	-Hedhja e mbeturinave dhe; -Mosmirëmbajtja e hapësirave gjelbëruese.	E lartë	-Ndikimi në peizazhe; -Degradim i hapësirës publike dhe; -Ndotja e tokës.	***
Tokat erozive  Bimësi e pakët, ndikim në erozion.	-Prerja ilegale e pyjeve; -Mungesa e pendëve mbrojtëse dhe; -Hedhja e mbeturinave në vendet e pacaktuara.	E lartë	-Përmbytja e vendbanimeve në kohë reshesh dhe; -Ulja e rendimenteve të kulturave në bujqësi.	**
Tokat ndërtimore  Shfrytëzim joracional i tokës ndërtimore.	-Mos zbatimi i ligjeve; -Mungesë e planeve rregulluese.	E lartë	-Pengon mundësinë e zhvillimit të prioriteteve; -Parregullsi urbanistike; -Zvogëlon cilësinë e mjedisit dhe; - Ndotjen e tokës.	**
Trafiku  Mungesa e vend-parkingjeve.	-Numri i automjeteve në rritje.	E mesme	-Rritja e nivelit të ndotjes në ajër; -Rritje e zhurmave në mjedis; -Dëmtimi i trotuareve dhe; -Rritja e pasigurisë së këmbësorëve.	**
Mungesa e parqeve dhe lulishteve.	-Mosinteresimi për investime në këtë drejtim; -Mungesa e një sektori për mjedis dhe; -Mungesa e buxhetit komunal në fushën e mjedisit.	E mesme	-Mungesë e mjedisve çlodhëse; -Ajër dhe ambient i papastër dhe; -Zvogëlon vlerat turistike të qytetit.	***

## Ajri

Problemi	Shkaku	Shkalla e ndikimit	Ndikimi	Prioriteti
Ndotja e ajrit nga emetimet e gazrave të dëmshme.	-Numri i madh i automjeteve pa filtër; -Gjeneratorët, si pasojë e mungesës së rrymës; -Djegia e mbeturinave dhe; -Dekompozimi i mbeturinave (deponitë ilegale) dhe ujërat e zeza.	E lartë	-Ndikimi në kualitetin e jetës të banorëve; -Rritja e problemeve astmatike të banorët dhe; -Ajër i papastër.	***
Ndotja e ajrit nga pluhuri.	-Strukturë jo-cilësore e rrugëve dhe; -Mospastrimi i duhur i rrugëve.	E mesme	-Ndikimi në shëndetin e popullsisë dhe; -Ndotje e ambientit.	***

## Biodiversiteti

Problemi	Shkaku	Shkalla e ndikimit	Ndikimi	Prioriteti
Biodiversiteti Mungesa e një strategjie për ruajtjen e florës dhe faunës dhe; Mungesa e një studimi për llojet e rrezikuara të specieve të veçanta.	-Mungesa e një strategjie për ruajtjen e biodiversitetit; -Mungesa e investimeve në këtë lëmi dhe; -Mungesa e një plani adekuat të veprimit për mbrojtjen e specieve në zhdukje.	E lartë	-Dëmtimi i florës dhe faunës; -Zhdukja e specieve të rralla, florës dhe faunës dhe; -Varfërimi dhe dëmtimi i habitateve.	***
Zvogëlimi i sipërfaqeve të gjelbëruara (pyje, livadhe etj.)	-Prerjet ilegale të pyjeve (në mënyrë jo racionale) dhe; -Erozioni, si pasojë e mosmirëmbajtjes së shtretërve të lumenjve.	E lartë	-Ndikim negativ në mjedis dhe; -Pakësim i llojeve të veçanta të florës dhe faunës.	***
Pakësim i llojeve veçanta të kafshëve të egra.	-Zvogëlimi i sipërfaqes pyjore; -Gjuetia e paligjshme gjatë kohës së shumimit dhe; -Mungesa e një strategjie për ruajtjen e llojeve të veçanta të kafshëve.	E lartë	-Prishja e ekosistemit (ekuilibrit ekologjik) dhe; -Ndikon negativisht në zhvillimin e faunës, gjuetisë sportive dhe turistike.	***
Zvogëlimi i llojeve të faunës në lumenj.	-Ndotja e lumenjve nga derdhjet e ujërave të zeza; -Gjuetia e peshkut në kohën e shumimit me mjete të ndaluara (gjeneratorë) dhe; -Prishja e biodiversitetit të lumit.	E lartë	-Pakësim i faunës së ujërave dhe zvogëlon cilësinë mjedisore dhe ekonomike.	***
Zonat e mbrojtura Mungesa për zbatimin e mekanizmit ligjor për mbrojtje të natyrës.	-Mos interesim i organeve kompetente dhe; -Rrezikimi nga dëmtimet e llojeve florës dhe faunës.	E lartë	-Ndikim negativ në mjedis;-Humbje e vlerave ekologjike dhe; -Dëmtimi i florës dhe faunës.	***
Ekosistemet specifike Dëmtimi i brigjeve të lumenjve.	-Eksplotimi i rërës në mënyrë të pa kontrolluar dhe; -Mosmarrja e masave për sanimin e terrenit të dëmtuar.	E lartë	-Ndryshim i rrjedhës së lumit, e si pasojë erozioni të brigjet dhe; -Degradim i mjedisit.	***

Mjedisi social dhe ekonomik

Problemi	Shkaku	Shkalla e ndikimit	Ndikimi	Prioriteti
Arsimi Mungesë e një strukture të plotë edukimi mjedisor në shkolla dhe në komunitete.	-Mungesë investimesh dhe; -Koordinim jo i mirë në mes institucioneve relevante.	E lartë	-Ndikim negativ në menaxhimin e natyrës; -Zvogëlon cilësinë qytetare të rajonit dhe; -Ndikon në rritjen e brezit të ri (ambientalist).	***
Bujqësia Zvogëlim i sipërfaqes së tokës.	-Copëzimi i tokave (fragmentimi i tokës bujqësore); -Lëvizja demografike e pa kontrolluar dhe; -Kthimi i tokës nga livadhe në tokë ndërtimore.	E lartë	-Ndikim në uljen ekonomike dhe; -Mosinteresim për tokën dhe kultivimin e qëndrueshëm bujqësorë.	***
Ulje e nivelit të punësimit në bujqësi.	-Nivel i ulët i prodhimit; -Mungesë subvencioneve dhe; -Mungesë e tregut të shitjes.	E lartë	-Të ardhura të pakta ekonomike dhe; -Nxitje e emigracionit.	***
Struktura e mbjelljeve jo e drejtë.	-Nuk ka prioritet për kultura bujqësore.	E mesme	-Zvogëlon cilësinë e tokës dhe; -Ndikim negative në zhvillimin e qëndrueshëm.	**
Blegtoria	-Mungesë investimesh në përmirësimin racor dhe; -Mos subvencionimi.	E lartë	-Rënie e të ardhurave ekonomike.	***
Mungesa e përpunimit dhe tregtimit të produkteve blegtorale.	-Mungesa e fondeve për teknologjinë e përpunimit.	E mesme	-Rritje e ulët e krerëve të bagëtive në raport me mundësitë ushqyese të kullotave.	**

Turizmi

Problemi	Shkaku	Shkalla e ndikimit	Ndikimi	Prioriteti
Mungesa e një politike për zhvillimin e turizmit.	-Mungesë e planifikimit në këtë fushë dhe; -Mungesa e buxhetit.	E lartë	-Shkallë e ulët e zhvillimit të turizmit dhe; -Zvogëlon mundësinë e të ardhurave nga ky sektorë.	***
Mungesa e qendrave të informimit.	Mungesë mjeteve financiare për promovime.	E lartë	-Zvogëlon vlerat turistike dhe; -Zvogëlon numrin e turistëve.	***
Mungesa e një strategjie të zhvillimit afatgjatë shoq-ekonomikë.	-Mungesa e mjeteve për hartimin e një plani afatshkurtër.	E lartë	-Formë e paorganizuar e turizmit.	***
Mungesa e paketave turistike profesionale për tërheqjen e klientëve të huaj dhe vendës.	-Mungesa e një promovimi profesional të produktit turistik e kulturor, i gërshetuar me aktivitete argëtuese.	E lartë	-Zvogëlon vlerat turistike.	***
Pamundësia e vizitave të zonave atraktive turistike.	-Mungesa e një rrjeti të mirëfillt të akteve rrugore.	E Larte	-Mos promovimi i zonës, mos shenjëzim profesional për zonat turistike.	***
Menaxhimi jo profesional i hoteleve.	-Staf me një nivel të ulët profesional dhe; -Mungesa e promovimit të restoranteve tradicionale.	E mesme	-Mos promovimi i zonës, mos shenjëzim profesional për zonat turistike.	**
Lokacione arkeologjike dhe historike të pa hulumtuara dhe të pambrojtura.	-Lënie pas dore dhe; -Mosinteresim i institucioneve relevante nga niveli qendror dhe lokal.	E lartë	-Degradim i vlerave turistike të rajonit dhe arkeologjike.	***
Mungesa e një kuadri promovues dhe menaxhues për ofertën turistike të vendit.	-Mungesa e trajnimeve për aftësimin e kuadrove dhe; -Mungesa e materialeve promovuese turistike (tabela orientuese, broshura, harta turistike etj.).	E lartë	-Mos zhvillim nga ana e institucioneve përkatëse dhe; -Zvogëlon vlerat turistike.	***

## Pjesa 4

### IV. PLANIFIKIMI I VEPRIMEVE

Veprimet:

Lista e veprimeve që duhet të ndërmerren për zgjidhjen e problemeve

Prioriteti - i matur me shkallën:

\* Pak i rëndësishëm

\*\* Mesatarisht i rëndësishëm

\*\*\* Shumë i rëndësishëm

Afati kohor - i matur me shkallën

Afatshkurtër, deri 5 vjet

Afatmesëm, deri 10 vjet

Afatgjatë, deri 15 vjet

Akterët përgjegjës dhe bashkëpunëtorët e mundshëm:

Mund të jenë institucionet që janë direkt përgjegjës për problemin, si dhe akterë të tjerë në rolin e bashkëpunuesit.

Efekti:

Një përshkrim i efektit pozitiv që vjen nga zgjidhja e këtyre problemeve.

1. Uji

Problemi	Veprimet	Prioriteti - Afati kohor	Akterët	Efekti
Lumenjtë - (përroskat, ujërat sipërfaqësore). Ndotja e ujit dhe degradimi i lumenjve dhe përroskave nga komuniteti dhe faktorët natyrorë.	-Ndalimi i hedhjes së mbeturinave në lumenj; -Ngritja e gardheve antierozive në brigjet e zhveshura dhe; -Rregullimi i shtretërve të lumenjve ("Lumëbardhi të Deçanit", "Lloqanit", dhe "Përroit të Behovcit").	*** Afatshkurtër	-Komuna; -Ministritë përkatëse; -Donatorët e mundshëm dhe; -Komuniteti.	-Ndërgjegjësimi i qytetarëve; -Mbrojtja e tokave nga përmbytjet dhe; -Uji i pastër për ujitje.
"Lumëbardhi i Deçanit" Derdhja e ujërave të zeza, të pa trajtuara dhe; Degradimi i rrjedhës së lumit (mbeturinat).	-Pastrimi dhe rregullimi i shtratit të lumit dhe; -Rregullimi i kanalizimit atmosferik dhe atij të ujërave të zeza.	*** Afatshkurtër	Ministritë përkatëse; -Donatorët dhe; -Komuna.	-Zgjidhja e problemit të ujërave të përdorura; -Mbrojtja e florës dhe faunës së lumit dhe; -Ambient i pastër.
Sistemi i ujitjes Dëmtimi i kanaleve të ujitjes.	Riparimi i kanaleve të ujitjes.	*** Afatshkurtër	-Komuna; -Ministritë përkatëse; -HidroDrini dhe; -Donatorët.	-Uji i pastër dhe; -Shtimi i sipërfaqes së tokës në sistemin e ujitjes.
Rrjeti i kanaleve të ujitjes; Sistemi i vjetruar i kanaleve të ujitjes dhe; Mungesa e pendëve.	-Betonimi i kanaleve të ujitjes; -Meremetimi i atyre ekzistuese dhe; -Ndërtimi i pendëve për ujitje (Grykën e Lloqanit).	*** Afatmesëm	-Ministritë përkatëse; -Komuna dhe; -Donatorët e mundshëm.	-Efikasitet më i lartë i përdorimit të ujit; -Rritje e prodhimeve bujqësore dhe; -Rritë mirëqenien e bujqve.
Ujërat nëntokësore dhe; Ndotja nga ujërat e zeza.	-Ndërtimi i kanalizimit për ujërat e zeza në pjesën rurale.	*** Afatmesëm	-Ministritë përkatëse; -Komuna dhe; -Donatorët e mundshëm.	-Ambient i pastër dhe; -Shëndeti më i mirë i popullatës.
Burimet Infrastrukturë e dobët afër burimeve të ujit.	-Rregullimi i ambientit përreth burimeve dhe; -Vendosja shportave dhe ulëseve për vizitorë.	*** Afatshkurtër	-Komuna dhe; -Donatorët.	-Ambient i pastër dhe atraktiv, dhe; -Nxitje e turizmit.
Burimet e ujërave minerale-mos shfrytëzimi i duhur i kapaciteteve.	-Hartimi i një strategjie për mundësitë e rritjes së kapaciteteve shfrytëzuese; -Rregullimi i infrastrukturës përreth burimeve dhe; -Hartimi i projekteve për shfrytëzim dhe promovimi i vlerave të këtyre burimeve.	** Afatmesëm	Ministritë përkatëse; Komuna dhe; Donatorët.	-Nxitje e zhvillimit ekonomikë të zonës; -Ambient i pastër dhe; -Zhvillimi i turizmit shëndetësorë.



2. Toka

Problemi	Veprimet	Prioriteti - Afati kohor	Akterët	Efekti
Copëtimi i sipërfaqeve të tokave.	-Të bëhet rigrupimi i sipërfaqeve të tokave (kamosacioni); -Nxjerrja e rregulloreve për përdorimin e tokave bujqësore dhe; -Hartimi i planeve rregulluese.	*** Afatgjatë	Ministritë përkatëse; Komuna dhe; Donatorët.	-Rritje e sipërfaqeve të tokës; -Rritja e rendimenteve bujqësore dhe; -Rritje e mirëqenies dhe përmirësim i mjedisit.
Përmbytjet e tokave bujqësore.	-Rregullimi i shtretërve të lumenjve; -Hapja e kanaleve kulluese dhe; -Pastrimi i kanaleve ujitëse dhe betonimi i tyre.	*** Afatshkurtër	Komuna; Ministritë dhe; Qytetarët.	-Ruajtja e sipërfaqes bujqësore; -Shtim i rendimenteve dhe; -Ambient i këndshëm.
Ulja e nivelit të punësimit në bujqësi dhe; Mosinteresimi për punimin e tokës.	-Stimulimi i fermerëve me kredia të volitshme; -Organizimi i trajnimeve për menaxhimin e pemishteve dhe mbjelljen e perime-kulturave të ndryshme; -Shtimi i masave stimuluese dhe; -Subvencioneve shtetërore për bujqësinë.	*** Afatmesëm	Ministritë; Komuna; Donatorët dhe; OJQ-të.	-Hapja e vendeve të reja të punës; -Zhvillim ekonomikë; -Ngritja e nivelit të njohurive të fermerëve përmes këshillave të inxhinierëve të bujqësisë dhe; -Aplikimi i teknologjive të reja në bujqësi.
Tokat pyjore.	-Ndalimi i shfrytëzimit pa kriter të kullosave.	** Afatgjatë	Komuna dhe; Ministritë përkatëse.	-Përmirësohet gjendja e kullosave dhe; -Zvogëlohet rreziku nga erozioni.
Tokat erozive; Prerja ilegale e pyjeve dhe; Zhveshja e sipërfaqeve të tokave nga gurëthyesit.	-Pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura; -Parandalimi i shfrytëzimit joracional i resurseve natyrore dhe; -Ndërtimi i pendëve.	*** Afatshkurtër	Ministritë; Komuna dhe; Donatorët.	-Zvogëlim i rrezikut nga erozioni; -Pengimin i prurjeve të ngurta nga përrenjtë malorë dhe; -Zvogëlon rrezikun nga përmbytjet e tokave bujqësore, po ashtu edhe në pjesën urbane.
Tokat ndërtimore.	-Zbatimi i ligjeve dhe; -Hartimi i planeve rregulluese.	*** Afatshkurtër	Qeveria dhe; Komuna.	-Ndalon parregullsitë urbanistike dhe; -Rrit cilësinë e mjedisit, zvogëlon shtimin mbeturinave dhe ndotjen e ajrit.

Shtimi i trafikut në qytet.	-Hartimi i studimeve për rrjetin ekzistues rrugor; -Hartimi i një studimi për mundësinë e përdorimit të mjeteve të pa-amortizuara (biçikletave) dhe; -Mundësia e linjës së autobusëve urbanë.	** Afatmesëm	Ministritë; Komuna dhe; Donatorët.	-Përmirësimi i qarkullimit të automjeteve dhe të këmbësorëve; -Zvogëlimi i numrit të automjeteve; -Zvogëlimi i rreziqeve në trafik dhe; -Përmirësimi i kualitetit të ajrit.
Mungesa e gjelbërimit në afërsi të vendbanimeve kolektive, përgjatë rrugëve dhe shkollave.	-Mbjellja e drunjtëve gjethembajtës, si bli, gështenjë e egër, acer, përgjatë rrugës dhe në parkun e qytetit; -Ngritja e parqeve dhe lulishteve nëpër pjesën rurale dhe; -Të bëhet rregullimi, përkatësisht gjelbërimi, i ambienteve të shkollave.	*** Afatshkurtër	Ministritë; Komuna dhe; Donatorët.	-Krijimi i mjediseve çlodhëse dhe argëtuese për komunitetin dhe; -Përmirësimi i peizazhit.
Mungesa e gjelbërimit në pjesën urbane - (Qendra e qytetit).	Të bëhet rregullimi dhe gjelbërimi, dhe; -Mbjellja e drunjtëve gjethembajtëse tipike vendore (gështenjë, bli etj.), në qendër të qytetit.	*** Afatshkurtër	Komuna dhe; Donatorët.	-Krijimi i mjediseve çlodhëse dhe argëtuese për komunitetin dhe; -Përmirësimi i peizazhit.

### 3. Ajri

Problemi	Veprimi	Prioriteti - Afati kohor	Akterët	Efekti
Ndotja e ajrit nga emetimi i gazrave të dëmshëm për shëndetin.	-Eliminimi i deponive të mbeturinave në vende urbane dhe rurale; -Parandalimi i djegies së mbeturinave dhe regjistrimi i automjeteve pa filtër; -Ndërtimi i një furre moderne për djegien e mbetjeve spitalore të rrezikshme (incenerator) dhe; -Instalimi i sistemit për monitorimin e cilësisë së ajrit në qytet.	*** Afatshkurtër	Ministritë; Komuna dhe; Donatorët.	-Zvogëlon rrezikun nga sëmundje të ndryshme të rrugëve respiratore, bronkiale dhe astme-bronkiale dhe kardiake, dhe; -Minimizim i ndotjes së ajrit, nga shpërbërja e mbetjeve organike në ajër dhe djegia e tyre.
Ndotja e ajrit nga pluhurat.	-Ngritja e cilësisë së pastrimit të qytetit, me mjete për larjen e rrugëve dhe; -Sigurimin e aparatit monitorues për matjen e cilësisë së ajrit nga ndotësit e ndryshëm.	*** Afatshkurtër	Ministritë; Komuna dhe; Donatorët.	-Përmirësimi i situatës mjedisore dhe; -Njohja e saktë e situatës së ndotjes së ajrit, si dhe rritjes së mundësisë e ndërhyrjes në zbutjen ndotësve në zona të banuara të qytetit.

## 4. Biodiversiteti

### 4. Biodiversiteti

Problemi	Veprimet	Prioriteti - Afati kohor	Akterët	Efekti
Biodiversiteti Rrezikimi i florës dhe faunës e sidomos i specieve të rralla.	-Të hartohet strategjia për ruajtjen e biodiversitetit; -Të bëhet studimi për llojet e rrezikuara të specieve të veçanta dhe mbrojta e tyre, dhe; -Nxjerrja/hartimi i një broshure promovuese me të gjitha llojet e florës dhe faunës.	*** Afatshkurtër	Ministritë; Komuna; Donatorët dhe; OJQ-të.	-Mbrojtja e specieve të veçanta të bimëve dhe shtazëve, dhe; -Ruajtja e ekosistemeve.
Zvogëlimi i sipërfaqeve të gjelbëruara.	-Ndalimi i prerjes ilegale në mënyrë jo racionale të pyjeve; -Pyllëzimi i peizazheve (Bjeshka Jodoves, Bjeshka e Deçanit, përgjatë lumenjve etj.), dhe; -Shpallja e zonave të veçanta.	*** Afatshkurtër	Ministritë; Komuna; Agjensioni pyjor dhe; Donatorët.	-Mbrojtja e ambientit; -Ruajtja e peizazheve dhe; -Ruajtja e vlerës ekologjike.
Problemi i pakësimit të gjitarëve.	Ndalimi i gjuetisë së paligjshme, si dhe gjuetisë në kohën e shumimit.	*** Afatshkurtër	Ministritë; Komuna; Shoqata e gjuetarëve dhe; Agjensioni pyjor.	-Ruajtja dhe shtimi i vlerave të larmisë biologjike dhe; -Shtimi i shtazëve dhe shpendëve të rrezikuar nga zhdukja.
Zvogëlimi faunës ujore.	-Ruajtja dhe kultivimi i troftës dhe specieve të tjera të lumenjve, dhe; -Ndalimi i hedhjes së mbeturinave të ndryshme.	*** Afatmesëm	Komuna; OJQ-të dhe; Shërbimi policor.	-Ruajtja e specieve të veçanta dhe; -Rritje e turizmit lumor (gjueti sportive dhe turistike).
Zonat e mbrojtura Mungesa e implementimit të infrastrukturës ligjore.	-Futja e tërë sipërfaqes së "Bjeshkëve të Nemuna" në kuadër të projektit për Shpalljen e "Bjeshkëve të Nemuna" - Park Nacional, dhe; -Sensibilizimi i komunitetit për njohjen e vlerave të zonave të mbrojtura dhe rëndësinë e tyre.	*** Afatshkurtër	Ministritë; Komuna; OJQ-të mjedisore dhe; Komuniteti.	-Ruajtja e ekosistemeve; -Ruajtja e florës dhe faunës, dhe; -Ruajtja dhe kultivimi i peizazhit.
Ekosistemet specifike Dëmtimi i sipërfaqeve të gjelbëruara nga gurthyesit.	-Detyrimi i shfrytëzuesve të zhavorrit, si dhe të gurthyesve për sanimin e sipërfaqeve të dëmtuara (kthim në gjendjen paraprake).	*** Afatshkurtër	Komuna; Ministritë; OJQ-të mjedisore dhe; Policia.	-Ruajtja e peizazhit të lumenjve; -Ruajtja e specieve të rralla dhe; -Zvogëlim i rrezikut nga erozioni.

5. Mjedisi social dhe ekonomik

Problemi	Veprimet	Prioriteti - Afati kohor	Akterët	Efekti
Arsimi  Mungesa e një strukture të plotë mjedisore në shkolla dhe në komunitete.  Mungesa e programeve mjedisore.	-Publikim i materialeve të shkruara, botim i librave për edukimin mjedisorë; -Lënda mbrojtja e mjedisit të bëhet lëndë obliguese e jo mësim zgjedhor nëpër shkolla; -Stimulimi i grupeve të të rinjve në projektet për pyllëzim, pastrim etj., dhe; -Publikimi i broshurave për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit dhe rrezikun për të kundërtën.	*** Afatshkurtër	Ministria e Arsimit dhe; Komuna.	-Krijimi i kushteve për rritjen e brezave, me dije dhe kulturën e duhur për mbrojtjen dhe ruajtjen mjedisit dhe; -Rritja e ndërgjegjes qytetare dhe krijimi i traditës mjedisore.
Bujqësia  Zvogëlimi i sipërfaqes së tokës.	-Të bëhet ri-grupimi i tokave (kamosacioni); -Të subvencionohen prodhuesit bujqësorë dhe; -Hapja e sipërfaqeve të tokës të mbuluara me shkurre.	*** Afatmesëm	Ministria përkatëse; Komuna dhe; Donatorët.	-Rritje e sipërfaqes së tokës punuese; -Zhvillimi ekonomikë dhe; -Rritë mirëqenien e popullatës.
Ulje e nivelit të punësimit në bujqësi.	-Aplikimi i teknologjive të reja në prodhimtarinë bujqësore; -Ofrimi i infrastrukturës adekuate për eksportin e prodhimeve bujqësore dhe; -Ngritja e serave për prodhimin e perimeve.	*** Afatshkurtër	Qeveria; Komuna; Donatorët dhe; Fermerët.	-Rritë mirëqenien; -Rritje e kapaciteteve prodhuese; -Prodhime të freskëta në çdo stinë dhe; -Zvogëlon importin e prodhimeve perimore.
Struktura e mbjelljeve joadekuate.	-Të rritet sipërfaqja e bimëve me varietete me prodhim të larta, si dhe të përshtaten kushteve natyrore të vendit dhe; -Stimulimi i prodhuesve përmes kredive të volitshme afatgjate.	*** Afatshkurtër	Qeveria; Komuna; Donatorët dhe; Fermerët.	-Nxit zhvillimin e qëndrueshëm dhe; -Strukturë e mbjelljeve e planifikuar.
Blegtoria	-Stimulim për shtimin e fondit në blegtori dhe; -Përmirësim i racave të kafshëve me potencial të lartë prodhimi.	*** Afatshkurtër	Ministria e Bujqësisë; Komuna dhe; Donatorët.	-Përmirësim i racave; -Rritje e mirëqenës dhe; -Shtim i prodhimit për treg.
Mungesa e reparteve për përpunimin e prodhimeve blegtorale.	-Përkrahje e blegtorëve përmes kredive të volitshme dhe afatgjate.	*** Afatshkurtër	Qeveria; Bankat dhe; Donatorët.	-Rritje e të ardhurave; -Shtim i fondit blegtoral dhe; -Aplikimi i teknologjive të reja prodhuese.

## 6. Turizmi

Problemi	Veprimet	Prioriteti - Afati kohor	Akterët	Efekti
Mungesa e donacioneve për zhvillimin e turizmit.	-Implementimi i strategjisë për zhvillimin e turizmit.	*** Afatshkurtër	Komuna; Ministria përkatëse; Donatorët dhe; OJQ-të mjedisore.	-Zhvillimi i qëndrueshëm turistik dhe; -Zhvillimi i eko-turizmit.
Mungese për zhvillimin e politikave turistike.	-Hapja e qendrës turistike; -Hartimi i një plani afatshkurtër për promovimin e llojeve të turizmit dhe; -Trajnimi i stafit profesional për përcjelljen e turistëve.	*** Afatshkurtër	Komuna; Ministria dhe; Donatorët.	-Zhvillimi i qëndrueshëm turistik.
Mungesa e paketave turistike profesionale për tërheqjen e turistëve.	-Hartimi i një plani rregullues që përcakton kriteret mjedisore për zhvillimin e turizmit.	*** Afatshkurtër	Ministritë; Komuna dhe; Donatorët.	-Mbrojtja e ambientit; -Zhvillim turistik i zonës dhe; -Shtim i vlerave turistike.
Mungesa e studimeve të atraksioneve turistike malore.	-Ndërtimi rrugës që lidhe Deçanin me Plavën (Malin e Zi) dhe; -Të bëhet evidentimi dhe hulumtimi i shpellave.	*** Afatshkurtër	Qeveria; Komuna; Donatorët; Komuniteti dhe OJQ-të mjedisore.	-Zhvillim i qëndrueshëm; -Mbrojtja e resurseve atraktive natyrore dhe; -Ruajtja e natyrës.
Menaxhimi joprofesional i hoteleve.	-Trajnimi i stafit shërbyes të hoteleve përmes seminareve dhe punëtorive të ndryshme nga trajner profesional dhe; -Përkrahja dhe promovimi i turizmit rural-zakoneve dhe ushqimeve tradicionale.	*** Afatshkurtër	Komuna; Ministria; Donatorët dhe; Biznesi privat.	-Rritja e fluksit të turistëve vendas dhe të huaj, dhe; -Promovimi i vlerave tradicionale të vendit.
Trashëgimia kulturore dhe arkeologjike e pa hulumtuar.	-Të bëhet hulumtimi dhe konservimi i trashëgimisë së pasur arkeologjike të lokalitetit, dhe; -Të bëhet hulumtimi, evidentimi dhe ruajtja e trashëgimisë së pasur kulturore, përmes botimeve të ndryshme (broshurave, guidave turistike etj.).	*** Afatshkurtër	Ministria; Komuna; Donatorët dhe; OJQ-të.	-Ruajtja e kësaj trashëgimie të pasur nga degradimi i mëtejshëm; -Rritje e vlerave turistike në vend; -Promovimi i zonës dhe; -Zhvillim ekonomikë.
Mungesa e materialeve promovues dhe menaxhuese të ofertës turistike.	-Hapja e ueb-faqes elektronike për promovimin e vlerave turistike në kuadër të administratës komunale; -Të hartohet guida turistike për nevojat e promovimit turistik të zonës dhe; -Të bëhet botimi i katalogëve, fletushkave, palosjeve dhe hartave turistike.	*** Afatshkurtër	Komuna; Ministria dhe; Donatorët.	-Zhvillim i turizmit; -Ngritja e vlerave turistike të Komunës dhe; -Zhvillim i qëndrueshëm.

## PLANI I VEPRIMIT PËR IMPLEMENTIM

### Trajtimi ujërave dhe mbrojtja e lumenjve

Aktiviteti (Projektet)	Prioriteti - Afati kohor	Organet përgjegjëse	Kostoja e përafërt në Euro	Efekti
Hartimi dhe harmonizimi i rregullores për mbrojtjen e mjedisit me infrastrukturën ligjore-mjedisore.	*** Afatshkurtër	Komuna; Ministria dhe; Donatorët.	5000	Ndalimi i ndotjes dhe; Përmirësimi i normave juridike.
Botimi i broshurave, palosjeve për trajtimin e ujerave dhe mbrojtjen e lumenjve.	*** Afatshkurtër	Komuna; Ministria dhe; Donatorët.	5000	Njoftimi i popullsisë me gjendjen e ujerave dhe menaxhimin e tyre.
Hartimi i projektit për pastrim dhe rregullim të shtratit të "Lumëbardhit të Deçanit".	*** Afatshkurtër	Komuna; Ministria dhe; Donatorët.	15000	Zgjidhja e problemit të ujërave të ndotura.
Pastrimi dhe rregullimi i shtratit të "Lumëbardhit të Deçanit".	*** Afatshkurtër	Qeveria; Donatorët dhe; Komuna.	25000	Zgjidhja e problemit të ujërave të ndotura; Mbrojtja e florës dhe faunës, dhe; Prodhimet bujqësorë-cilësore.
Hartimi i projektit për pastrim dhe rregullim të shtratit të "Lumëbardhit të Lloqanit".	*** Afatshkurtër	Komuna; Ministria dhe; Donatorët.	15000	Zgjidhja e problemit të ujërave të ndotura.
Pastrimi dhe rregullimi shtratit të "Lumëbardhit të Lloqanit".	*** Afatshkurtër	Donatorët; Komuna dhe; Ministria.	25000	Ambient i pastër; Rritja e ndërgjegjes qytetare për krijimin e traditave për mbrojtjen e mjedisit; Shtim i sipërfaqes së tokës në sistemin e ujitjes.
Hartimi i projektit për rregullim të shtratit të "Përroit të Behovcit".	*** Afatshkurtër	Komuna; Donatorët dhe; Ministria.	5000	Mbrojtja e tokave nga përmbytjet dhe; Ujë i pastër.
Hartimi i projektit për kanal të ujitjes në lagjen "Nagip Cacaj" – Deçan.	*** Afatshkurtër	Ministria; Komuna; Donatorët dhe; KRU "Drini i Bardhë".	2000	Rritje e kapacitetit të ujit për ujitje; Uji i pastër dhe; Ambient i pastër.
Ndërtimi i pendës në "Grykën e Lloqanit".	*** Afatshkurtër	Komuna; Donatorët dhe; Ministria.	20000	Ujitje e tokave; Zhvillim i bujqësisë dhe; Shtim i sipërfaqeve në sistemin e ujitjes.
Hartimi i projekteve për ujitje me bio-filtër, që prodhimet të jenë ekologjike.	*** Afatshkurtër	Komuna; Donatorët dhe; Ministria.	20000	Zhvillim i bujqësisë dhe; Prodhimeve ekologjike.
Hartimi i projektit për rregullimin e infrastrukturës dhe shfrytëzimin e burimeve të ujërave-minerale (Gushavci).	*** Afatshkurtër	Komuna; Donatorët dhe; Ministria.	50000	Zhvillim ekonomik dhe; Nxitje e turizmit shëndetësorë.

## Ndërtimi i kanalizimeve për ujërat e zeza dhe kolektorëve

Aktiviteti	Prioriteti - Afati kohor	Organet përgjegjëse	Kostoja në Euro	Efekti
Hartimi i projektit për ndërtimin e kanalizimit për lokalitet rurale.	** Afatmesëm	Komuna; Donatorët dhe; Ministria.	15000	-Mbrojtja e ambientit; -Përmirësim i cilësisë së ujit të pijshëm dhe; - Përmirësim i kushteve sanitare të zonave rurale.
Ndërtimi i kanalizimit për fshatrat: Dranoc, Voksh, Pobergjë dhe Lloqan.	** Afatmesëm	Komuna; Donatorët dhe; Ministria.	150000	-Ujë i pastër dhe; -Përmirësim i kushteve sanitare të zonave rurale.
Ndërtimi i kanalizimit për fshatrat: Lëbush, Strellc i Eperm, Strellc i Ultë, Isniq, Dubovik, Prapaqan, Papiq.	** Afatmesëm	Komuna; Donatorët dhe; Ministria.	100000	-Ujë i pastër dhe; -Ambient i shëndoshë.
Ndërtimi i kanalizimit për fshatrat: Prejlep, Rastovicë, Prokolluk, Irzniq, Ratishtë, Glllogjan, Shaptej.	** Afatmesëm	Komuna; Donatorët dhe; Ministria.	50000	-Ambient i pastër.
Ndërtimi i kanalizimit për fshatrat: Dubrave, Gramaçel, Baballoç.	** Afatmesëm	Ministria; Donatorët; Komuna dhe; Komuniteti.	30000	Ambient i pastër.
Kyçja e objekteve publike (Pallati i Kulturës, Kuvendi Komunal), në rrjetin e kanalizimit të ujërave të zeza, rregullimi i hapësirave publike në qendër të qytetit, rregullimi i gjelbërimit.	*** Afatshkurtër	Komuna; Donatorët dhe; Ministria.	60000	Ambient i këndshëm për qytetarë.
Ndërtimi i impiantit kryesorë për trajtimin e ujërave të zeza për Komunën e Deçanit.	** Afatmesëm	Komuna; Donatorët dhe; Ministria.	100000	Zvogëlim i rrezikut nga sëmundjet dhe; -Mbrojtja e ekosistemeve të lumenjve nga ndotja.

## Menaxhimi i mbeturinave

Aktiviteti	Prioriteti - Afati kohor	Organizata përgjegjëse	Kostoja e përafërt në Euro	Efekti
-Ngritja e kapaciteteve për menaxhimin e mbeturinave (stafin që menaxhon mbeturinat); -Hartimi i një plani të veprimit për menaxhimin e mbeturinave; -Hartimi i rregullores komunale dhe; -Startimi me programet për selektimin e mbeturinave.	*** Afatshkurtër	Ministria; Donatorët dhe; Komuna.	5000	Mbrojtje e ambientit dhe; Staf i trajnuar.
Botimi i broshurave, palosjeve, për reduktimin e mbeturinave, riciklimin dhe rregullimin e deponive.	*** Afatshkurtër	Komuna; Ministria; Donatorët dhe; OJQ-të.	5000	Informim i popullatës me gjendjen e mbeturinave dhe ambientit.
Shtirja e sistemit të mbledhjes së mbeturinave në zonat rurale.	** Afatmesëm	Ministria; Komuna dhe; Donatorët.	25000	Zgjidhje e qëndrueshme për komunitetin për një kohë të gjatë.
Eliminimi i deponive ilegale.	*** Afatshkurtër	Ministria; Komuna dhe; Donatorët.	10000	Ambient i pastër.
Furnizimi me kontejnerë për ekonominë familjare në pjesën urbane dhe rurale.	*** Afatshkurtër	Ministria; Komuna dhe; Donatorët.	60000	Zgjidhje e qëndrueshme për komunitetin për një kohë të gjatë.
Rehabilitimi i lokacioneve (gjelbërimi), pas mbylljes së deponive ilegale.	*** Afatshkurtër	Ministria; Komuna dhe; Donatorët.	20000	Ambient i pastër.

Mbrojtja nga erozioni dhe vërshimet

Mbrojtja nga erozioni dhe vërshimet

Aktiviteti	Prioriteti - Afati kohor	Organizata përgjegjëse	Kostoja e përafërt (€)	Efekti
Rregullimi i shtratit të "Lumëbardhit të Deçanit".	*** Afatshkurtër	Ministria; Komuna dhe; Donatorët.	1000000	Pengimi i erozionit dhe mbrojtja nga vërshimet.
Rregullimi i shtratit të "Lumëbardhit të Lloqanit".	*** Afatshkurtër	Ministria; Komuna dhe; Donatorët.	300000	Pengimi i erozionit dhe mbrojtja nga vërshimet.
Ndërtimi i pendës mbrojtëse në "Grykën e Lloqanit".	*** Afatshkurtër	Ministria; Komuna dhe; Donatorët.	20000	Mbrojtja e qytetit nga vërshimet dhe inertet.
Pastrimi i pendës mbrojtëse në "Llukë të Epërme".	*** Afatshkurtër	Ministria; Komuna dhe; Donatorët.	2000	Pengimi i erozionit dhe mbrojtja nga vërshimet.
Rregullimi i shtratit të "Përroit të Behovcit".	*** Afatshkurtër	Ministria dhe; Komuna.	150000	Mbrojtja e tokave bujqësore nga vërshimet.
Ndërtimi i kanalit për ujijtë në rrugën "Nagip Cacaj" – Deçan.	*** Afatshkurtër	Ministria; Komuna dhe; Donatorët.	70000	Mbrojtja e tokave bujqësore nga vërshimet.

Ajri

Aktiviteti	Prioriteti - Afati kohor	Organizata përgjegjëse	Kostoja	Efekti
Ndërtimi i inceneratorit për djegien e mbeturinave spitalore.	*** Afatshkurtër	Ministria; Komuna dhe; Donatorët.	Kosto pa llogaritur	Minimizon ndotjen e ajrit nga shpërbërja e mbetjeve spitalore.
Ngritja e një qendre hidrologjike për matjen e të reshurave, temperaturës, lëvizjes së ajrit.	*** Afatshkurtër	Ministria; Komuna dhe; Donatorët.	50000	Njohje e saktë e gjendjes së ndotjes së ajrit.



Zonat e gjelbra

Aktiviteti	Prioriteti - Afati kohor	Organizata përgjegjëse	Kostoja	Efekti
Hartimi i Strategjisë për ruajtjen e biodiversitetit.	*** Afatshkurtër	Ministria; Komuna dhe; Donatorët.	Nuk është llogaritur.	Ruajtja e ekosistemeve.
Sensibilizimi i komunitetit për mbrojtjen e ambientit përmes botimit të broshurave, palosjeve etj.	*** Afatshkurtër	Ministria; Komuna dhe; Donatorët.	4000	Ndërgjegjësim i komunitetit.
Hartimi i planit rregullues Urban për Zonën e Mbrojtur "Kozhnjerri".	*** Afatshkurtër	Ministria; Komuna dhe; Donatorët.	7000	Ruajtja e ekosistemeve.
Hartimi i planit rregullues Urban për Zonën e Rëndësisë së posaçme.	*** Afatshkurtër	Ministria; Komuna dhe; Donatorët.	6000	Ruajtja e vlerave natyrore.
Hartimi strategjisë për menaxhimin e zonave të mbrojtura.	*** Afatshkurtër	Ministria; Komuna dhe; Donatorët.	7000	Ruajtja e vlerave natyrore.
Caktimi i zonave të gjuetisë.	*** Afatshkurtër	Ministria; Komuna dhe; Donatorët.	5000	Ruajtja e ekosistemeve.
Të hartohen dhe të jetësohet projekte adekuate për Zonat e Mbrojtura me kushte që ato peizazhe vitale (mushkëritë e Deçanit) të jetë pjesë e qytetit të ardhshëm Ekologjik.	*** Afatshkurtër	Ministria; Komuna dhe; Donatorët.	30000	Ruajtja e vlerave natyrore.
Pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura në "Bjeshkën e Deçanit", "Judovës", "Carrabregut" etj.	*** Afatshkurtër	Ministria; Komuna dhe; Donatorët.	20000	Mbrojtja dhe ruajtja e biodiversitetit.
Hartimi dhe implementimi i projektit për Kopshtin Botanik.	*** Afatshkurtër	Ministria; Komuna dhe; Donatorët.	20000	Ambient i këndshëm për qytetarë.
Hartimi projektit për këndin e lojërave për fëmijë.	*** Afatshkurtër	Ministria; Komuna dhe; Donatorët.	Nuk është llogaritur	Ambient i këndshëm për qytetarë.
Gjelbërimi i hapësirave urbane (Qendër të qytetit), rregullimi dhe pastrimi i kanalit më gjatësi 50m, ndriçimi, ulëse, kyçja e ujerave të zeza në kanalizim, shtruarja me kubeza e trotuareve dhe një hapësirë para ndërtesave kolektive.	*** Afatshkurtër	Ministria; Komuna dhe; Donatorët.	60000	Ambient i këndshëm për qytetarë dhe ambient i pastër.
Ngritja e parqeve, zonave të gjelbëruara, nëpër fshatra.	** Afatmesëm	Ministria; Komuna dhe; Donatorët.	Nuk është llogaritur	Ambient i pastër.
Ngritja e parqeve dhe rregullimi hapësirave shkollore.	*** Afatshkurtër	Ministria; Komuna dhe; Donatorët.	10000	Mbrojtja e shëndetit të nxënësve.
Rregullimi i Parkut publik (Podin e Gështenjave).	*** Afatshkurtër	Ministria; Komuna dhe; Donatorët.	30000	Pamje e bukur dhe ambient i pastër.
Identifikimi i Deçanit si zonë e vetme për kultivimin dhe furnizimin me gështenja dhe fryte pyjore: boronica, çaja, kërpudhat dhe bimë mjekësore.	*** Afatshkurtër	Ministria; Komuna dhe; Donatorët.	10000	Kultivim i vlerave natyrore.

## Zhvillimi i turizmit

Aktiviteti	Prioriteti - Afati kohor	Organizata përgjegjëse	Kostoja	Efekti
Hartimi i strategjisë për zhvillimin e turizmit.	*** Afatshkurtër	Ministria; Komuna; Donatorët dhe; OJQ-të.	5000	Zhvillimi turistik i Komunës.
Hartimi i Planit për Ndërtimin shkollës së turizmit.	*** Afatshkurtër	Ministria; Komuna; Donatorët dhe; OJQ-të.	100000	Zhvillimi turistik i Komunës.
Botimi i pakos turistike, me broshura, palosje, harta për njoftimin e vizitorëve me ofertën turistike.	*** Afatshkurtër	Ministria; Komuna dhe; Donatorët.	5000	Promovimi i vlerave turistike të Komunës.
Shënjëzimi i objekteve historike, vendndodhjeve arkeologjike dhe hulumtimi i tyre.	*** Afatshkurtër	Ministria; Komuna dhe; Donatorët.	5000	Ruajtja e vlerave historike, kulturore dhe arkeologjike.
Hartimi i Planit Rregullues Urban për Qendrën Turistike.	*** Afatshkurtër	Ministria; Komuna dhe; Donatorët.	15000	Zhvillimi i një turizmi të qëndrueshëm.
Ngritja një qendre turistike në "Bjeshkën e Belegut" me infrastrukturë përcjellëse.	**** Afatmesëm	Ministria; Komuna dhe; Donatorët.	200000	Zhvillimi i një turizmi të qëndrueshëm.
Ndërtimi i rrugës Deçan-Plavë (Mali i Zi).	*** Afatshkurtër	Ministria; Komuna dhe; Donatorët.	Prioritet	Nxitja dhe zhvillimi i turizmit rajonal.
Të bëhet identifikimi dhe hulumtimi i shpellave.	*** Afatshkurtër	Ministria; Komuna dhe; Donatorët.	5000	Zhvillimi i speleo-turizmit.
Ngritja e fshatit turistik në "Belle".	**** Afatmesëm	Ministria; Komuna dhe; Donatorët.	2000000	Zhvillimi i turizmit malor.
Planifikim dhe rregullimi i shtigjeve.	**** Afatmesëm	Ministria; Komuna dhe; Donatorët.	5000	Zhvillimi i turizmit malor.
Promovimi i produkteve turistike.	**** Afatmesëm	Ministria; Komuna dhe; Donatorët.	5000	Zhvillimi i turizmit malor.
Zhvillimi i turizmit rural dhe eko-turizmit.	*** Afatshkurtër	Ministria; Komuna dhe; Donatorët.	5000	Zhvillimi i turizmit malor.
Zhvillimi i turizmit ndërkufitar (Kosovë-Shqipëri-Mali i Zi).	*** Afatshkurtër	Ministria; Komuna dhe; Donatorët.	Prioritet	Nxitja dhe zhvillimi i turizmit rajonal.

## Trashëgimia kulturore dhe natyrore

Aktiviteti	Prioriteti - Afati kohor	Organizata përgjegjëse	Kostoja	Efekti
Shenjëzimi i monumenteve natyrore dhe kulturore (botimi i hartave).	*** Afatshkurtër	Komuna; Ministria dhe; Donatorët.	5000	Turizëm i zhvilluar dhe; Ruajtja e trashëgimisë.
Hartimi për promovimin e trashëgimisë kulturore si: lojërave të vjetra popullore, traditat, zakonet, ritet etj.	*** Afatshkurtër	Komuna; Ministria dhe; Donatorët.	5000	Ruajtja e trashëgimisë kulturore.
Botimi i broshurave, guidave për trashëgiminë kulturore.	*** Afatshkurtër	Komuna; Ministria dhe; Donatorët.	5000	Nxitja e turizmit kulturor.
Hulumtimi i lokaliteteve arkeologjike – “Kulla e Qelisë”.	*** Afatshkurtër	Komuna; Ministria dhe; Donatorët.	5000	Ruajtja e trashëgimisë kulturore.



## Pjesa 5

### V. LISTA E PRIORITETEVE MJEDISORE

#### 1. REZULTATET E ANKETËS PËR PRIORITETET


#### DEÇANI

##### SHPËRNDARJA E MOSTRËS PËR KOMUNËN E DEÇANIT

Komuna	Gjinia		Meshkuj (51 %)					Femra (49 %)				
	Mosha # i resp.	>18	18-25	25-50	50-65	65+	>18	18-25	25-50	50-65	65+	
Deçan	500	26	51	110	51	17	25	49	106	49	16	


#### 1. PERCEPTIMI PËR GJENDJEN E TANISHME MJEDISORE

##### 1.1. Gjendja e tanishme mjedisore në territorin e Komunës suaj:




##### 1.2. Pesë (5) problemet kryesore në fushën e mjedisit në Komunën tuaj:


**1.2. Pesë (5) problemet kryesore në fushën e mjedisit në Komunën tuaj:**



**1.3. Tre ndotësitë (3) kryesorë të mjedisit në territorin e Komunës suaj:**



**1.4. Rrumbullakësoni tri (3) problemet që më së shumti ndikojnë negativisht në cilësinë e jetës në lagjen tuaj:**



Pas analizimit të rezultateve të anketimit, anëtarët e Grupit Punues dhe Grupit Koordinues janë përcaktuar për katër fushat prioritare që do të trajtohen me Planin Lokal për Veprim në Mjedis.

**Prioriteti 1 - Menaxhimi i ujërave të zeza**

**Aktivitete Ligjore dhe Politike (L)**

Aktiviteti	Lokacioni	Përshkrimi	Kriteri/Indikatorët e suksesit
L1	Deçan	Hartimi i rregullores komunale për zbatimin e legjislacionit qendror për aktivitetet ndotëse.	Ulja e ndotjes dhe mbrojtja e resurseve ujore.
L2	Deçan	Hartimi i rregullores komunale për detyrimet e bizneseve lidhur me shkarkimet e ujerave të përdorura.	Identifikimi i nr. të bizneseve si ndotës potencial.

**Aktivitete Administrative dhe Inspektuese (A)**

Aktiviteti	Lokacioni	Përshkrimi	Kriteri/Indikatorët e suksesit
A1	Deçan	Themelimi i shërbimit profesional për menaxhimin e ujit dhe kanalizimit.	Mirëmbajtja e ujësjellësit dhe kanalizimit.
A2	Deçan	Ngritja e kapaciteteve për inspektorët mjedisorë.	Numri i stafit të trajnuar.
A3	Deçan	Kampanjë vetëdijesimi për mbrojtjen e mjedisit/resurseve ujore.	Nr. i pronarëve të bizneseve dhe banorëve të trajnuar, broshurat e botuara, mediat dhe OJQ-të lokale.

**Aktivitete Teknike dhe Teknologjike (T)**

Aktiviteti	Lokacioni	Përshkrimi	Kriteri/Indikatorët e suksesit
T1	Deçan	Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit.	Ulja e ndotjes.
T2	Deçan	Shtrirja e rrjetit të kanalizimit në zonat urbane dhe rurale.	Përmbledhës për shkarkim ujerave në impiantin.
T3	Deçan	Ndërtimi i pusetave dhe lidhja e objekteve publike në kanalizim të ujërave të zeza.	Numri i pusetave.
T4	Deçan	Ndërtimi i sistemit të kanalizimit kolektiv në zonat rurale/trajtimi biofushor dhe gropat septike.	Vendbanimet rurale me sistem të kanalizimit.
T5	Deçan	Ndërtimi i kanaleve të hapura për ujërat atmosferik në zonat rurale.	Mbrojtja dhe sigurimi cilësisë së ujë-rrjedhave.

**L1 Plani i detajuar i implementimit të aktiviteteve**

Lokacioni	Deçan
Aktiviteti	L1
Emri i aktivitetit	Hartimi i rregullores komunale për zbatimin e legjislacionit qendror për aktivitetet ndotëse.
Objektivi	Zhvillimi i rregullores në përputhje me legjislacionin aktual dhe përforcimi i gjobave në nivel lokal.
Komente	Ky projekt duhet të jetë prioritar për Komunën me përfshirjen e donatorëve kyç, pasi është faza e parë për zgjidhjen e problemeve të ndotjes së ujë-rrjedhave.

Fazat e punës		Organizata përgjegjëse	Vlera e përafërt (€)
1	Formimi i grupit punues.	Komuna dhe MMPH.	1000
2	Involvim i ekspertëve për hartimin e rregullores komunale dhe debati publik.	Komuna, MMPH, OJQ-të dhe donatorët.	10000
3	Aprovimi dhe publikimi i dokumentit final.	Komuna.	2000
		<b>Totali</b>	<b>13000</b>

Plani i implementimit

Fazat e punës	Viti i parë				Viti i dytë				Viti i tretë				Viti i katërt
	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	
1	X												
2		X											
3			X										

L2 Plani i detajuar i implementimit të aktiviteteve

Lokacioni	Deçan
Aktiviteti	L2
Emri i aktivitetit	Hartimi i rregullore komunale për detyrimet e bizneseve lidhur me shkarkimet e ujërave të përdorura.
Objektivi	Zhvillimi i rregullore për mbrojtje të ujë-rrjedhave, e cila përputhet me legjislacionin qendror dhe vendos detyrimet dhe gjoha ndaj bizneseve, si ndotës potencial në Komunë dhe njëkohësisht krijon mundësinë e gjenerimit të mjeteve për Komunën.
Komente	Ky projekt duhet të jetë prioritar për Komunën me përfshirjen e donatorëve kyç, pasi është faza e parë për zgjidhjen e problemeve të ndotjes së lumenjve dhe menaxhimin e ujërave të zeza.

Fazat e punës		Organizata përgjegjëse	Vlera e përafërt (€)
1	Formimi i grupit punues.	Komuna dhe donatorët.	1000
2	Involvim i ekspertëve për hartimin e rregullore komunale dhe debati publik.	Komuna, MMPH, OJQ-të dhe donatorët.	10000
3	Aprovimi dhe publikimi i dokumentit final.	Komuna dhe donatorët.	1000
		Totali	12000

Plani i implementimit

Fazat e punës	Viti i parë				Viti i dytë				Viti i tretë				Viti i katërt
	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	
1				X									
2						X							
3							X						

A1 Plani i detajuar i implementimit të aktiviteteve

Lokacioni	Deçan
Aktiviteti	A1
Emri i aktivitetit	Themelimi i shërbimit profesional për menaxhimin e ujit dhe kanalizimit.
Objektivi	Mirëmbajtja dhe menaxhimi i ujësjellësit dhe kanalizimit. Ofrimi i shërbimeve cilësore për popullatën.



